VENDIM
Nr. 410, datë 3.6.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 173, DATË 24.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE 2023–2030, PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ, SI DHE PLANIT TË ZBATIMIT TË GARANCISË RINORE 2023–2025", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 173, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030, planit të veprimit për zbatimin e saj, si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023–2025", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në titull dhe në pikën 1, periudha "2023–2025" zëvendësohet me "2026–2028";

b) Shtojca nr. 3, me titull "Garancia rinore, plani i zbatimit 2023–2025" zëvendësohet me shtojcën nr. 3, me titull "Plani i zbatimit të garancisë rinore 2026–2028", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, INSTAT-i dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI I ZBATIMIT TË GARANCISË RINORE 2026–2028

"Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore 2026–2028" u hartua nga grupi teknik i punës për garancinë rinore, ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 28, datë 24.2.2022, "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës dhe të grupit teknik të punës, për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit kombëtar të garancisë rinore, si dhe caktimin e koordinatorit kombëtar", ndryshuar në 20.5.2024, në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi.

Hartimi i planit u mbështet përmes asistencës teknike e projektit "BE për rininë", financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP-ja dhe UNICEF-i në Shqipëri.

1. Konteksti

Shqipëria po përjeton një periudhë **me rritje ekonomike të konsiderueshme**. Gjatë tre vjetëve të fundit, PBB-ja është rritur vazhdimisht mbi 4% (4,05% në vitin 2024 dhe 4,02% në

vitin 2023) (INSTAT, 2025). Në vitin 2021, rritja e PBB-së ishte mbi 8%, duke përmbysur situatën negative të shkaktuar nga pandemia e COVID-19 në vitin 2020.

Rritja e regjistruar shfaq **dinamika të ndryshme në varësi të sektorit të veprimtarisë**. Sektori i shërbimeve përbën 49% të prodhimit të brendshëm bruto dhe ka regjistruar një rritje prej 6,5% në terma realë. Brenda sektorit të shërbimeve, spikat kontributi i transportit, turizmit dhe mikpritjes, të cilat përbëjnë një të katërtën e rritjes së regjistruar në vitin 2024. Një kontribut të rëndësishëm në PBB kanë dhënë edhe administrata publike, arsimi dhe shëndetësia, të cilat përfaqësojnë po ashtu një të katërtën e rritjes së PBB-së. Gjithashtu, veprimtaritë shkencore, administrative dhe për mbështetjen e biznesit kontribuuan me 0,5% në rritjen e PBB-së. Nëse shtojmë kontributin e sektorit të ndërtimit (0,53% të PBB-së) (INSTAT, 2025), këta katër sektorë përbëjnë së bashku tre të katërtat e rritjes së PBB-së në vitin 2024. Ekonomia shqiptare po orientohet gjithnjë e më shumë drejt shërbimeve, ku turizmi, administrata publike dhe shërbimet për mbështetjen e biznesit po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm.

Nga njëra anë, kjo dinamikë reflekton lindjen e mundësive të konsiderueshme për zgjerimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës dhe, nga ana tjetër, nevojën për të ndjekur strategji që parandalojnë përqendrimin e tepërt të veprimtarive në një numër të vogël sektorësh. Në të dyja rastet, investimi në strategji që synojnë të forcojnë kapitalin njerëzor të popullsisë më të re është një faktor suksesi. Plani i Garancisë Rinore është pjesë e strategjive që mund të mbështesin nxitjen dhe diversifikimin e veprimtarisë ekonomike dhe të forcojnë zinxhirin të saj të vlerës.

Dinamizmi pozitiv ekonomik është reflektuar në performancën e tregut të punës. Punësimi u rrit me 2,4 pikë përqindjeje midis vitit 2023 dhe tremujorit të tretë të vitit 2025 (INSTAT). Nga ana tjetër, shkalla e papunësisë ka pësuar rënie dhe është pozicionuar në nivelin 8,1% në tremujorin e tretë të vitit 2025, çka përbën një ulje prej 2,8 pikë përqindjeje që nga viti 2023. Ndonëse në grupmoshën 15 deri në 29 vjeç papunësia vijon të jetë më e lartë se mesatarja, rënia ka qenë e konsiderueshme, përkatësisht nga 25,6% në vitin 2023 në 15% në tremujorin e tretë të vitit 2025 (INSTAT, 2025). Kështu, popullsia aktive është rritur që nga prezantimi i Planit të parë të Garancisë Rinore, duke ndryshuar ndjeshëm profilin e personave që nuk janë të përfshirë në punësim, arsim apo trajnim (NEET).

Këto shifra nuk tregojnë vetëm performancën e mirë të ekonomisë shqiptare, por edhe aftësinë e saj për të krijuar vende pune për të rinjtë. Ky tregues lidhet ngushtë me përpjekjet e bëra në politikat rinore dhe ofron një perspektivë shumë shpresëdhënëse mbi kontributin që mund të japë Plani i Garancisë Rinore për forcimin dhe rritjen e cilësisë së pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës.

Megjithëse vijojnë të ekzistojnë rreziqe, për shkak të kontekstit ekonomik ndërkombëtar të karakterizuar nga konfliktet, tensionet tregtare dhe pasiguria ekonomike, të cilat mund të ndikojnë më lehtësisht në sektorin e turizmit, sektorin financiar dhe sektorin e pasurive të paluajtshme, **perspektiva afatshkurtër dhe afatmesme për ekonominë shqiptare është optimiste** (rritja ekonomike pritet të mbetet rreth 3,5% në terma afatmesëm, 2026–2028). Ky kontekst pozitiv përforcohet nga procesi i anëtarësimit në BE, i cili mobilizon shoqërinë shqiptare dhe siguron angazhim të fortë politik.

Në këtë këndvështrim, **Plani i Garancisë Rinore duhet të shihet si një strategji kyçe për të mbështetur rritjen dhe modernizimin** e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare, duke përfshirë kualifikimin e administratës së saj publike. Prandaj, **Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore është ambicioz dhe mundëson vazhdimësinë e procesit të reformës së politikave të arsimit, trajnimit dhe punësimit, si dhe konsolidimin e kuadrit institucional që siguron zbatimin e tij**. Në të njëjtën kohë, ai kërkon të diversifikojë gamën e shërbimeve dhe të përgjigjeve që mund të garantojnë mundësi më të mira punësimi dhe jetese për të rinjtë NEET. Kontributi i tij duhet të rrisë performancën e sektorëve kryesorë, duke mbështetur njëkohësisht diversifikimin

e bazës ekonomike, duke ndihmuar në uljen e emigrimit të punonjësve të rinj të kualifikuar dhe duke siguruar ruajtjen e vazhdueshme të ritmit në reformat strukturore të nevojshme për vendin. Këto reforma duhet të kontribuojnë në rritjen e barabartë, rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës në ekonomi, krijimin e më shumë vendeve të punës, si dhe në përmirësimin e qeverisjes dhe ofrimin e shërbimeve publike. Të rinjtë janë në qendër të kësaj sfide.

Bashkimi Evropian dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë që mbështesin qeverinë në ndjekjen e kësaj strategjie zhvillimi janë thelbësorë për suksesin e saj.

2. Profili i popullsisë NEET: përditësim

Zhvillimet e kohëve të fundit në tregun e punës në Shqipëri kanë qenë pozitive, duke përfshirë në lidhje me grupmoshën 15–29 vjeç që mbulohet nga Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore (PZGR). **Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës u rrit me 2,8 pikë përqindjeje** gjatë periudhës 2020–2024, shkalla e punësimit u rrit gjithashtu me 3,2 pikë përqindjeje në 44,4%, ndërsa shkalla e papunësisë ra nga 21% në 18,9% (tabela 1). Në vitin 2024, shkalla e papunësisë afatgjatë te të rinjtë ishte 12,8%. Megjithatë, pavarësisht progresit të arritur, **niveli i pjesëmarrjes së të rinjve në tregun e punës** kërkon vëmendje të shtuar nga plani i detajuar i ndërhyrjes së garancisë rinore.

Tabela 1: *Treguesit e tregut të punës për grupmoshën 15–29 vjeç*

15–29	2020	2023	2024	T3 2025
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës	52%	53,5%	54,8%	53,5 %
Shkalla e punësimit	41,2%	41,9%	44,4%	45,5 %
Shkalla e papunësisë	21%	21,7%	18,9%	15,0 %
Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës 2020, 2023, 2024, 2025				

Shkalla e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe shkalla e punësimit zbulojnë pabarazi të konsiderueshme midis djemve dhe vajzave të grupmoshës 15–29 vjeç. Pjesëmarrja në tregun e punës është 11,7 pikë përqindjeje më e ulët për vajzat ndërsa shkalla e punësimit është 9,6 pikë përqindjeje më e ulët për djemtë. Pabarazia gjinore në tregun e punës është një problem i rëndësishëm, që duhet të adresohet përmes politikave aktive të punësimit.

Në vitin 2024, **përqindja e të rinjve NEET ishte 22,2%, çka përbënte një rënie të ndjeshme krahasuar me nivelin 27,9% të regjistruar në vitin 2020**. Ndarja sipas gjinisë tregon një diferencë prej 5 pikë përqindjeje midis burrave (19,7%) dhe grave (24,7%). Në vitin 2020, kjo diferencë ishte 6%, çka tregon një ulje të lehtë të kësaj pabarazie. Kështu, megjithëse përqindja e të rinjve NEET ka evoluar në mënyrë shumë të favorshme gjatë pesë vjetëve të fundit, ajo mbetet e lartë dhe shumica e të rinjve NEET vijojnë të jenë gra.

Në vitin 2024, u përditësua profilizimi/karakterizimi i të rinjve NEET, një ushtrim ky që mbështeti zhvillimin e planit fillestar të zbatimit të garancisë rinore (PZGR). Profilizimi i zhvilluar është llogaritur mbi të dhënat e Censit 2023 për të gjithë popullsinë e grupmoshës 15–29 vjeç dhe shkallën ekzistuese të të rinjve NEET. Në Shqipëri, më 2023-shin rezultuan gjithsej 105 861 të rinj NEET, nga të cilët 49 966 janë djem dhe 55 895 janë vajza.

Në vitin 2023, **48,9 për qind e të rinjve NEET, ose 51,766 individë në total, ishin të papunë[1]. Pjesa tjetër prej 51,1 përqindësh (54,095 individë në total) ishin jashtë forcave të punës**. Ndërkohë, në tremujorin e tretë të 2025-s, sipas të dhënave të publikuara nga INSTAT-i, numri i të rinjve të papunë rezulton 32,569. Nga të rinjtë NEET jashtë forcave të punës, 2,0 për qind ishin punonjës të dekurajuar, 13,4 për qind ishin joaktivë, për shkak të përgjegjësive familjare dhe 24 për qind ishin të rinj joaktivë për arsye të tjera. Në vitin 2020,

[1] Shifrat në vlera absolute janë përllogaritje që bazohen në numrin total të popullsisë të grupmoshës 15–29 vjeç nga Censi 2023, duke aplikuar përqindjet e të rinjve NEET dhe treguesit e tregut të punës të llogaritur nga Anketa e Forcave të Punës (AFP).

të rinjtë NEET joaktivë përbënin 65% të totalit. Tabela më poshtë tregon ndarjen e popullsisë NEET sipas kategorive/nëngrupeve.

Tabela 2: *Ndarja e popullsisë së të rinjve NEET në nëngrupe*

15–29	2023
Të papunë	49%
Të papunë afatshkurtër	*15%*
Të papunë afatgjatë	*34%*
Të rinj që rihyjnë në tregun e punës	7%
Joaktivë, për shkak të përgjegjësive familjare	13%
Të sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	5%
Punonjës të dekurajuar	2%
Joaktivë për arsye të tjera	24%
Burimi i informacionit: Anketa e Forcave të Punës, 2023	

Krahasuar me të dhënat nga ushtrimi i profilizimit i kryer në vitin 2021, ka pasur një **ulje të ndjeshme në përqindjen e të rinjve NEET joaktivë** (-13,9 pikë përqindjeje) dhe, rrjedhimisht, brenda këtij grupi, në përqindjen e punonjësve të dekurajuar, e cila ra nga 15,2% në 2%. **Përqindja e të rinjve NEET joaktivë, për shkak të përgjegjësive familjare ka mbetur relativisht e qëndrueshme**, dhe sipas të dhënave, është ulur me 2,2 pikë përqindjeje nga viti 2020 në vitin 2023. Numri i të rinjve NEET të përfshirë në kategorinë "joaktivë për arsye të tjera" mbetet i lartë, megjithëse ka rënë me 4,6 pikë përqindjeje.

Niveli arsimor i të rinjve NEET tregon se në vitin 2023, 35 për qind kishin arsim bazë, 44 për qind kishin arsim të mesëm, ndërsa 21% kishin arsim të lartë.

Tabela 3: *Niveli arsimor i të rinjve NEET*

15–29	2023
Arsim i detyrueshëm	35%
Arsim i mesëm	44%
Arsim i lartë	21%

Dallimet gjinore tregojnë se vajzat dhe gratë NEET kanë nivel më të lartë arsimor krahasuar me burrat NEET. Të dhënat rreth nivelit arsimor tregojnë se 28 për qind e **vajzave dhe grave** NEET kanë arsim të lartë krahasuar me 12 për qind të burrave NEET. Shkalla e arsimit të mesëm tregon një hendek prej 8 pikë përqindjeje midis burrave NEET dhe **vajzave dhe grave** NEET. 46% e burrave NEET kanë arsim të mesëm, ndërsa në rastin e vajzave dhe grave NEET kjo shifër është 38%. Shkalla e arsimit bazë është e njëjtë për burrat NEET dhe vajzave dhe grave NEET (34 për qind).

Megjithëse zhvillimet e kohëve të fundit në tregun e punës tregojnë një tendencë pozitive, vijojnë sfidat që prekin grupmoshën më të re. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për grupmoshën 15–29 vjeç ishte 53,5% në vitin 2023 dhe mbetet në të njëjtin nivel edhe në tremujorin e tretë të vitit 2025.

Shkalla e punësimit për të rinjtë e moshës 15–29 vjeç ishte 44% në vitin 2023 dhe është rritur në 45,5% në tremujorin e tretë të vitit 2025, duke treguar një përmirësim prej 1,5 pikë përqindjeje në periudhën krahasuese. Krahasuar me vitin 2018, shkalla e punësimit për këtë grupmoshë mbetet më e lartë me 5,5 pikë përqindjeje.

Sa i përket papunësisë së të rinjve, ndonëse vijon të jetë më e larta ndër grupmoshat, ka shënuar rënie të ndjeshme. Në vitin 2023, shkalla e papunësisë për të rinjtë ishte 21,7%, ndërsa në tremujorin e tretë të vitit 2025 ajo është ulur në 15,0%. Kjo përfaqëson një rënie domethënëse prej 6,7 pikë përqindjeje, e cila përkon në kohë me periudhën e zbatimit të Planit të Garancisë Rinore në Shqipëri, duke sugjeruar një ndikim pozitiv të ndërhyrjeve të synuara në integrimin e të rinjve në tregun e punës.

3. Përmbledhje e Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore

Në këtë pjesë të dokumentit paraqitet një përmbledhje e progresit kryesor të arritur gjatë tre vjetëve të parë të zbatimit të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore. Qëllimi nuk është të jepet një vlerësim i detajuar i zbatimit të planit, por të theksohen rezultatet kryesore të përftuara përmes zbatimit të reformave dhe nismave të planifikuara, si dhe sfidat që mbeten ende dhe që duhet të adresohen përmes planit të ri. Kjo përmbledhje e shkurtër është organizuar sipas fazave të zbatimit të PZGR-së, duke theksuar fillimisht disa zhvillime ndërsektoriale që janë shumë të rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të planit.

Zhvillimet ndërsektoriale

Zhvillimi i fazës së pilotimit, rezultatet kryesore të së cilës janë paraqitur në seksionin e mëposhtëm, ishte një arritje thelbësore për të testuar procedurat, efikasitetin e masave dhe për të ngritur kapacitetet.

Plani fillestar Kombëtar i Pilotimit u hartua në vitin 2023 dhe përfshinte tri bashki pilot: Tiranë, Shkodër dhe Vlorë, dhe u shtri në nivel rajonal në janar të vitit 2025. Pilotimi u planifikua dhe u koordinua nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA). **Krahas zbatimit të planit të pilotimit, u hartua një plan monitorimi, sipas standardeve të Komitetit të Punësimit të Komisionit Evropian (EMCO)**. Qasja e monitorimit u mbështet në Dokumentin Operacional për Pilotimin e Garancisë Rinore dhe u testua gjatë pilotimit.

Si rrjedhojë e zbatimit të projektit pilot dhe testimit të procedurave të zbatimit që ai mundësoi, në vitin 2024, **AKPA-ja përgatiti dhe miratoi dokumentin "Udhëzimet për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe aftësive sipas Skemës së Garancisë Rinore"**. Udhëzimet përbëjnë një instrument metodologjik që do të mbështesë zgjerimin e planit, si dhe do të shërbejnë, gjithashtu, si bazë për strategjinë e trajnimit të specialistëve të ndryshëm që do të përfshihen në zbatimin e planit. Këto zhvillime çojnë në krijimin e një kuadri monitorimi. Që nga viti 2024, AKPA-ja zhvillon tregues për monitorimin e planit të pilotimit, duke ndjekur rekomandimet e EMCO-s.

Për të mbështetur menaxhimin e zbatimit të planit të pilotimit dhe për t'u përgatitur për shtrirjen e tij në nivel kombëtar, u projektua dhe u zhvillua një modul i posaçëm për monitorimin e Garancisë Rinore, i cili do të integrohet në sistemin e informacionit të shërbimeve të punësimit të AKPA-s, duke krijuar kushtet për shtrirjen e planit në të gjithë territorin kombëtar dhe për të mundësuar referimet nga aktivitetet e informimit te shërbimet përgatitore në mënyrë digjitale.

Koordinatori Kombëtar i Garancisë Rinore hartoi një plan për monitorimin e garancisë rinore me qëllim ndjekjen e zbatimit të planit të miratuar, për çdo masë, ndërhyrje dhe përgjegjësi institucionale të caktuar. Gjatë periudhës së zbatimit, koordinatori kombëtar i garancisë rinore zhvilloi takime të rregullta të grupit teknik të punës të garancisë rinore, si dhe përgatiti dhe shpërndau raportet vjetore të progresit.

Faza 1: Hartëzimi

Gjatë fazës së parë të zbatimit të PZGR-së, u arritën disa rezultate kryesore:

- Profilizimi i të rinjve NEET u përditësua në vitin 2024 për të mbështetur përgatitjen e planit të ri dhe për të orientuar zbatimin e vazhdueshëm të planit. Në vitin 2024, INSTAT-i përpunoi të dhënat vjetore për popullsinë NEET për periudhën 2021–2023, bazuar në AFP-në dhe në përputhje me udhëzimet metodologjike të ndara nga organizatat ndërkombëtare që mbështesin zbatimin e garancisë rinore. Shifrat kryesore të këtij profilizimi u paraqitën në një seksion të mëparshëm të këtij dokumenti. Krahas përditësimit të profilizimit të popullsisë NEET, u krye një analizë e burimeve të disponueshme të informacionit dhe instrumenteve të mbledhjes së të dhënave, si dhe u hartëzuan zhvillimet e nevojshme për të siguruar një analizë më të plotë dhe të thelluar të popullsisë NEET. Kështu, plani aktual rikonfirmon sfidën e konsolidimit të instrumenteve të mbledhjes së të dhënave për popullsinë NEET, veçanërisht

duke përfshirë tregues shtesë në Anketën e Forcave të Punës (AFP), Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ) ose çdo burim tjetër që mund të jetë i përshtatshëm.

- Gjatë periudhës së parë të zbatimit të Planit të Garancisë Rinore, u arrit progres në **zbatimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm** (SPH), veçanërisht përmes shtrirjes së tij në një numër më të madh shkollash të AFP-së dhe të përgjithshme (14 shkolla të AFP-së dhe 84 shkolla të përgjithshme). Në kontekstin e procesit të zgjerimit të SPH-së, u kryen aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për mësuesit (75), specialistët (836) dhe drejtorët e shkollave (166) në shkollat pjesëmarrëse, duke konsoliduar burimet pedagogjike dhe aftësitë e nevojshme, si kurrikulat, manualet e trajnimit dhe mjetet e sigurimit të cilësisë, për të mbështetur zbatimin e SPH-së në një nivel më të gjerë.

- Në këtë fazë, fusha e tretë ku u vërejtën zhvillime të rëndësishme ishte **këshillimi për karrierën**. Në këtë drejtim, spikat trajnimi dhe mobilizimi i koordinatorëve të këshillimit për karrierën për të mbështetur mësuesit dhe nxënësit në nivelin e arsimit të mesëm. U trajnuan pesëdhjetë e gjashtë koordinatorë nga zyrat vendore të arsimit, të cilët më pas trajnuan mësuesit kujdestarë dhe drejtuesit e shkollave në mbarë vendin. Për të mbështetur aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve të koordinatorëve të këshillimit për karrierën, u zhvilluan, gjithashtu, udhëzues metodologjikë dhe seanca informuese mbi aktivitetet e orientimit për karrierën. Në vitin 2023, u miratua zyrtarisht një udhëzues orientimi për karrierën. Gjithashtu, Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) përmirësoi shërbimet e orientimit për karrierën, duke krijuar komisione të posaçme në shkolla, duke organizuar aktivitete ndërgjegjësuese dhe duke pilotuar programin "Edukimi për karrierën" me Bashkinë e Tiranës. Institucionalizimi dhe rritja e integrimit të sistemit të këshillimit dhe orientimit për karrierën është një zhvillim që do të ndiqet në fazën e re të zbatimit të Planit të Garancisë Rinore.

- Faza e hartëzimit parashikoi zhvillime në identifikimin e **nevojave të tregut të punës,** për sa u përket kualifikimeve dhe aftësive. Rezultatet kryesore të arritura deri më sot përfshijnë zhvillimin e strategjive për konsultimin e punëdhënësve në nivel rajonal, të cilat mbështetën planifikimin afatmesëm të ofertave të AFP-së për të përshtatur programet arsimore me nevojat e tregut të punës. Procesi i konsultimit i kryer përmes Komiteteve Sektoriale të Aftësive (KSA) lejoi AKAFPK-në të rishikojë disa programe të AFP-së, bazuar në të dhënat e marra nga punëdhënësit. Me qëllimin për të zgjeruar analizën e tendencave të tregut të punës për sa i përket kërkesës për aftësi, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) dhe AKPA iniciuan Analizën Kombëtare të Nevojave për Aftësi (SNA), për të identifikuar kërkesat aktuale dhe të ardhshme për aftësi. Kjo do të ndihmojë në përshtatjen e arsimit dhe formimit me nevojat e punëdhënësve.

Faza 2: Kontaktimi

Gjatë fazës së parë të zbatimit të PZGR-së, u arritën disa rezultate kryesore:

- Në këtë fazë të zbatimit të planit, iu dha përparësi **aktiviteteve të informimit**, në lidhje me skemën e Garancisë Rinore. Nismat kryesore në këtë fushë përfshinin zhvillimin e një fushate komunikimi dhe lançimin e një Portali *online* të Garancisë Rinore. Portali përmban informacion të strukturuar në lidhje me shërbimet dhe ofertat e disponueshme për të rinjtë në skemë dhe përfaqëson një "dritare" të rëndësishme për skemën midis të rinjve. Portali lejon regjistrimin paraprak të të rinjve përmes *e-Albania,* të cilët konfirmohen më pas nga Zyrat e Punës, si punëkërkues të papunë të regjistruar zyrtarisht, duke nisur kështu rrugëtimin e tyre në skemën e garancisë rinore. Fushata kombëtare e komunikimit fokusohet te nxitja e pjesëmarrjes së të rinjve dhe forcimi i përpjekjeve për të arritur personat që kanë nevojë për mbështetje. Kjo ndërhyrje rriti ndjeshëm vizibilitetin e skemës në nivel kombëtar dhe vendor.

- Zhvillimi i **Modelit të Kontaktimit** ishte një arritje kyçe e PZGR-së së parë. Modeli u zhvillua në vitin 2024 dhe filloi të testohej dhe zbatohej në vitin 2025. Ai parashikon një qasje të lokalizuar dhe të koordinuar, bazuar në krijimin e Rrjeteve të Partneritetit Vendor (RrPV). U përgatit modeli për RrPV-të, e cila përshkruan shtyllat kryesore të ndërhyrjes, aktorët dhe

rolet përkatëse, modelin e partneritetit dhe strategjitë e burimeve financiare. Rrjeti përfshin bashkitë, institucionet e arsimit parauniversitar dhe institucionet ofruese të shërbimeve sociale, organizatat rinore, shërbimet vendore të punësimit, këshillat rinorë vendorë dhe partnerët socialë. Aktualisht po mbështetet ngritja e kapaciteteve të partnerëve dhe miratimi i mekanizmave të bashkëpunimit. Modeli prezanton, gjithashtu, rolin e "Punonjësit rinor" në organizatat rinore, në përputhje, gjithashtu, me ligjin e ndryshuar nr. 75/2019, "Për rininë", i cili vepron si një urë lidhëse midis të rinjve NEET dhe shërbimeve ekzistuese. Për të mbështetur nisjen e partneriteteve vendore në rajonet pilot, u hartua dhe zbatua një skemë grantesh për të mbështetur aktivitetet e OJF-ve të përfshira në fazën e kontaktimit.

- Krahas krijimit të **Rrjeteve të Partneritetit Vendor**, u bënë përpjekje për të aktivizuar të 61 Këshillat Rinorë Vendorë, siç ishte planifikuar, me qëllim nxitjen e zbatimit të strategjive vendore për mbështetjen e të rinjve. Gjithashtu, u promovuan aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të tyre, ofrimin e asistencës teknike dhe zhvillimin e manualeve udhëzuese, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit të tyre në kuadër të PZGR-së.

- Së fundi, duhet të theksohet se **ndryshimet në ligjin nr. 75/2019, "Për Rininë",** synojnë të përmirësojnë mekanizmat institucionalë, të prezantojnë një përkufizim ligjor për NEET-në, të zgjerojnë mandatet e këshillave rinorë për të përfshirë grupet e cenueshme, të njohin grupet joformale rinore për të pasur të drejtën e financimit dhe të mandatojnë qendrat rinore shumëfunksionale dhe programet kombëtare për punësimin, sipërmarrjen, kulturën dhe angazhimin qytetar, në përputhje me standardet e BE-së.

Faza 3: Përgatitja

Gjatë fazës së parë të zbatimit të PZGR-së, u arritën disa rezultate kryesore:

- Një nga prioritetet në qasjen e fazës përgatitore ishte **ngritja e kapaciteteve të institucioneve** që ofrojnë këto shërbime. Në këtë kontekst janë forcuar kapacitetet e stafit në zyrat e punës, qendrat e formimit dhe shkollat profesionale, për të përmirësuar koordinimin e shërbimeve në nivel vendor dhe rajonal. Si pjesë e fazës së pilotimit të garancisë rinore, stafi në zyrat vendore të punësimit u trajnuan periodikisht për "Zbatimin dhe monitorimin e skemës së garancisë rinore", "Këshillimin për punësim dhe sipërmarrje", si dhe "Menaxhimin e integruar të rasteve", me qëllim nxitjen e qasjes së një përgjigjeje të individualizuar ndaj popullsisë NEET.

- Krahas përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve, u zhvillua një Udhëzues Metodologjik për **Këshillimin dhe Orientimin** e të rinjve NEET, i cili kontribuon në mbështetjen e strukturave vendore të punësimit në ofrimin e orientimit dhe këshillimit për karrierën në kontekstin e shërbimeve përgatitore.

- Qëllimi i përfshirjes së **shërbimeve të reja përgatitore** në skemën e garancisë rinore është përmbushur me zhvillimin e praktikave të reja në zhvillimin e aftësive sociale dhe digjitale, të ofruara në bashkëpunim me Qendrat e Formimit Profesional (QFP). Këto aftësi janë pjesë e paketës së shërbimeve të punësimit që u ofrohet të gjithë punëkërkuesve të papunë dhe janë të integruara në shërbimet e garancisë rinore. Procesi përfshin, gjithashtu, këshillimin për karrierën dhe teknikat e kërkimit për punë, të përshtatura sipas nevojave individuale.

- Në vitin 2024 u miratua **Programi i Riintegrimit Social** (VKM nr. 401, datë 19.6.2024). Ky program gjashtëmujor synon të ofrojë këshillim të specializuar për punësimin, mbështetje për vetëpunësimin dhe formim profesional.

- Periudha fillestare e zbatimit të PZGR-së që aktualisht është drejt përfundimit dhe mësimet nga faza e pilotimit nënvizojnë se për të siguruar pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me praktikat e rekomanduara evropiane, është e nevojshme të forcohen shërbimet e punësimit, ku përfshihen këshillimi i integruar, instrumentet e reja për orientimin dhe vendimmarrjen për karrierën, si dhe shërbimet e posaçme. Kjo qasje duhet të aktivizohet me përfshirjen e Rrjeteve të Partneritetit Vendor, siç parashikohet në qasjen e partneritetit tashmë të zhvilluar.

Faza 4: Oferta

Gjatë periudhës së zbatimit të PZGR-së, faza e ofertave i dha prioritet prezantimit të reformave ligjore për të mundësuar akses më të mirë të të rinjve NEET në masat mbështetëse dhe për të zhvilluar disa oferta të reja. Aktualisht, sfida kryesore është konsolidimi i portofolit ekzistues të ofertave dhe zgjerimi progresiv i mbulimit të tyre. Gjatë periudhës së raportimit u realizuan disa arritje kryesore:

- Me miratimin e ligjit nr. 32/2024, që amendon ligjin nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", **u rishikua struktura aktuale e AFP-së**. U bënë ndryshime në nenin 16, paragrafi 4, në lidhje me kualifikimet dhe nivelet profesionale. Me përfundimin e arsimit të mesëm profesional (me kohëzgjatje tre vjet pas arsimit bazë), nxënësit mund të përftojnë nivelin 3 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KShK). Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale dhe lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional ose hyrjen në tregun e punës.

U hartuan dhe u miratuan **drejtime të reja profesionale postsekondare**. Gjatë periudhës:

- Në vitin 2024, filloi një reformë madhore: zbatimi i **Modelit të dyfishtë të AFP-së (AFP-ja duale)** në Shqipëri. Bazuar në VKM-në nr. 691 (6.11.2024) dhe urdhrin e ministrit nr. 1109 (16.12.2024), modeli u pilotua fillimisht në 10 shkolla të AFP-së në 8 bashki, duke mbuluar 6 fusha profesionale: mikpritja, kulinaria, multimedia, shërbimet autoelektrike, menaxhim hoteleri dhe instalime. U përfshinë 100 biznese partnere, duke siguruar bashkëpunim praktik midis arsimit dhe tregut të punës.
- Në nivel politikash, vlen të theksohet **rishikimi i bërë në vitin 2023 i katër programeve të nxitjes së punësimit** për të adresuar më mirë nevojat e të rinjve NEET (bazuar në VKM-në nr. 17 dhe VKM-në nr. 535). Gjithashtu, në këtë kontekst, u miratua një program i "Të nxënit në vendin e punës" për të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç (VKM nr. 264/2023), i cili ofron një program trajnimi 3–6-mujor pasuar nga 6 muaj punësim.
- Po kryhet një analizë e **vlerësimit të ndikimit** për të përforcuar efektivitetin e këtij grupi të ri të programeve.

Në kuadër të zbatimit të fazës pilot të garancisë rinore, është pilotuar një program i ri të garancisë rinore, të nxënit në vendin e punës, sipas skemës së garancisë rinore. Ky program do të sigurojë që punëkërkuesit e papunë të trajnohen për një periudhë 3 deri 6-mujore në vendin e punës në subjektet që do të bëhen pjesë e programit. Pilotimi i skemës u realizua përgjatë vitit 2025 në 4 biznese, përkatësisht në sektorin e hoteleri-turizmit dhe të ndërtimit.

- Pavarësisht progresit të rëndësishëm të bërë në konsolidimin e ofertave të mobilizuara në kuadër të PZGR-së, vijojnë të ekzistojnë sfida në drejtim të qëllimit të ofrimit të ofertave mjaftueshëm të larmishme për të përmbushur profilet e ndryshme të popullsisë NEET. Në këtë drejtim, ekziston nevoja për të forcuar kapacitetet në drejtim të arsimimit të vazhduar dhe programeve të shanseve të dyta.

4. Rezultatet kryesore të pilotimit

Projekti pilot për zbatimin e garancisë rinore filloi në fund të vitit 2023 dhe vijon ende. Në fazën e tij fillestare, zbatimi u kufizua në bashkitë e Tiranës, Vlorës dhe Shkodrës, ndërsa më vonë u zgjerua në nivel rajonal duke mbuluar të gjitha bashkitë e këtyre tri qarqeve.

Lançimi i projektit pilot u parapri nga zhvillimi i një plani veprimi që udhëhoqi zbatimin e tij. Në përgjithësi, plani i pilotimit të garancisë rinore synonte të ofronte bazat për shtrirjen në nivel kombëtar të Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore (PZGR).

Sipas planifikimit, pilotimi u fokusua te prioritetet e mëposhtme:

- Zbatimi dhe testimi i mekanizmave thelbësorë të monitorimit dhe zbatimit të nevojshëm për zbatimin e garancisë rinore dhe harmonizimi i tyre me standardet e EMCO-s.
- Sigurimi i ofrimit të shërbimeve dhe ofertave të përshkruara në plan.

Gjithashtu, faza e pilotimit përfshiu edhe zbatimin e reformave fillestare të parashikuara në PZGR.

- Testimi i strategjisë së informimit, që nënkupton se pilotimi jo vetëm që do të validonte mekanizmat kryesorë të zbatimit, por edhe instrumentet për aktivizimin e të rinjve NEET.

Për të organizuar pilotimin, u bë një dallim i qartë midis shërbimeve dhe ofertave që do t'u ofrohen të rinjve NEET dhe veprimtarive mbështetëse të nevojshme për shtrirjen e skemës. Ndaj, plani i veprimit e ndau planifikimin e projektit pilot në dy pjesë: identifikimi i shërbimeve dhe ofertave që do të ofrohen dhe përcaktimi i veprimtarive mbështetëse që do të zhvillohen.

Në tabelën më poshtë paraqiten ofertat e dhëna gjatë pilotimit.

Tabela 4: *Shërbimet dhe ofertat e projektit pilot*

Ofrimi i shërbimeve	**Ofertat**		
	Trajnim dhe arsimim i vazhduar	**Aktivitete në vendin e punës/punësimi**	**Trajnim/ Aprenticepship**
Zhvillim i planeve individuale të punësimit	Kurs Formimi Profesional	Punësim/Vetëpunësim	Programi i të nxënit në vendin e punës, sipas garancisë rinore
Udhëzim dhe orientim	Arsim i mesëm profesional	Ndërmjetësim për punësim	
Mentorim/këshillim individual dhe në grup	Arsim i mesëm profesional postsekondar	Program i punësimit (VKM nr. 17)	
Kurse trajnimi: aftësi transversale dhe kyçe (p.sh. aftësi digjitale, kursi "Aftësi për punësim")	Programi i praktikave profesionale (VKM nr. 17)	Programi i formimit nëpërmjet punës	
Shërbime ndërmjetësimi për punësim dhe trajnim/punësim	Arsim i dyfishtë në AFP	Program i punëve publike në komunitet	
Trajnime mbi aftësitë sociale dhe digjitale	Programi i kodimit	Program i vetëpunësimit	

Së fundi, shtrirja e planit të pilotimit shërbeu si një mundësi për të zbatuar modelin e qeverisjes së PZGR-së në nivelin e koordinimit, me synim forcimin e rolit të koordinimit ekzekutiv të PZGR-së dhe nxitjen e funksionimit të rregullt të grupit teknik të punës (GTP) përmes planifikimit dhe orientimit të zbatimit.

Tabela më poshtë paraqet rezultatet kryesore të veprimtarive të kryera gjatë projektit pilot midis periudhës nëntor 2023–korrik 2025. Struktura e raportimit ndjek standardet e përcaktuara nga EMCO.

Tabela 5: *Hyrjet e të rinjve NEET në projektin pilot të garancisë rinore*

Ndarja sipas seksit (§63) dhe moshës (§64)	Totali i pjesëmarrësve (§57)	Statusi në hyrje (§68-69)
		papunë i regjistruar
Totali (burra dhe gra)		
Totali i moshës 15-29	2,199	2,199
15-19	388	388
20-24	948	948
25-29	863	863
Burra		
Totali i moshës 15-29	984	984
15-19	216	216
20-24	422	422
25-29	346	346
Gratë		
Totali i moshës 15-29	1,215	1,215
15-19	172	172
20-24	526	526
25-29	517	517

Në total, gjatë kësaj periudhe, u mbuluan 2252 të rinj NEET të regjistruar si të papunë. Përfaqësimi i grave është pak më i lartë krahasuar me burrat. Grupmosha më e përfaqësuar është 20–24 vjeç, ndërsa të rinjtë NEET të grupmoshës 15–19 vjeç përbëjnë një përqindje relativisht të vogël.

Tabela e mëposhtme tregon daljet nga shërbimi i garancisë rinore sipas llojit të ofertës dhe kohëzgjatjes. Rreth 85.6[2] % e daljeve ishin pozitive brenda periudhës katërmujore. Daljet nga shërbimi për qëllime punësimi dhe arsimi përbëjnë nivelin më të lartë dhe 37.2% e daljeve për qëllime punësimi përkojnë me mundësitë e mbështetura nga subvencionet publike. Numri i të rinjve NEET që marrin pjesë në Programin e Praktikave të Punës është që tanimë i konsiderueshëm.

Tabela 6: *Daljet e të rinjve NEET në projektin pilot të garancisë rinore*

Ndarja sipas seksit (§63), moshës (§64) dhe kohëzgjatjes (§77-78)	Totali (të gjitha daljet)	Ndarja sipas destinacionit (§79-80)										
		Destinacione pozitive								Destinacione negative		I panjohur
		Totali				Nga të cilat të subvencionuara						
	Totali	Punëtor	Edukim	Nxënës.	Praktikant.	Punëtor (zëvendësues)	Eduk. (zëvendës.)	Nxënës. (zëvendësues)	Praktikant. (zëvendësues.)	Papunësi	I paveprueshëm.	
Totali i daljeve (të gjitha kohëzgjatjet)												
Totali (burra dhe gra)												
Totali i moshës 15-29	1,683	858	568	-	161	472	50	-	161	27	24	45
15-19	298	69	198	-	11	34	5	-	11	5	6	9
20-24	765	381	248	-	108	223	25	-	108	10	8	10
25-29	620	408	122	-	42	215	20	-	42	12	10	26

- Projekti pilot kishte një objekt të kufizuar dhe, si i tillë, shërbeu kryesisht si kontekst për testim dhe mësim. Të dhënat e mbledhura nga projekti pilot na lejojnë të nënvizojmë pikat e mëposhtme:

- Ekziston një **infrastrukturë e avancuar digjitale** që mundëson menaxhimin e programit.

- Është vënë në dispozicion **një grup ofertash gjithëpërfshirëse, relevante dhe të larmishme** (punësim i subvencionuar, trajnim, vetëpunësim, aftësi digjitale, praktikë profesionale në formën e dyfishtë).

- Mekanizmat e monitorimit janë funksionalë dhe sigurojnë ndjekje efektive të projektit gjatë zbatimit të tij.

- Aktivitetet e informimit duhet të përmirësohen për të angazhuar të rinjtë NEET, të cilët janë më të shkëputur nga shërbimet publike të punësimit. Gjithashtu, duhet të tejkalohet mbështetja në oferta të subvencionuara, e cila rrezikon qëndrueshmërinë financiare gjatë fazës së shtrirjes.

- Duke pasur parasysh përqindjen relativisht të lartë të të rinjve NEET me kualifikime të ulëta, faza e ardhshme e zbatimit të PZGR-së duhet të synojë **të rrisë referimet në mundësitë e arsimit dhe formimit**. Ky zhvillim duhet të ndihmojë, gjithashtu, në përmirësimin e angazhimit midis të rinjve NEET.

- Është thelbësore që **portofoli i shërbimeve të diversifikohet** dhe të përshtatet me ofertat për të zgjeruar strategjitë e daljes nga Garancia Rinore.

- Për të mbështetur shtrirjen në nivel kombëtar, **zgjerimi i mundësive në kuadër të masave të ofertave do të jetë një zhvillim kritik**, si dhe do të përforcojë koordinimin midis shërbimeve të punësimit, arsimit, shërbimeve sociale dhe bashkive.

[2] Të dhënat e EMCO për periudhën nëntor 2023–nëntor 2025.

- Me zgjerimin e planit, **ruajtja e treguesit të performancës për daljet brenda katër muajve do të bëhet sfiduese**, gjë që duhet të shihet si pasojë e natyrshme e fazës së shtrirjes.

5. Masat e Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore

Identifikimi i masave të përfshira në PZGR-në e ri realizohet sipas fazave, duke marrë parasysh identifikimin e masave dhe objektivat e tyre, grupin e synuar që ato synojnë të mbulojnë, si dhe institucionet dhe afatin kohor të përgjithshëm të zbatimit.

- Plani i ri i Zbatimit të Garancisë Rinore do të zëvendësojë planin fillestar, të miratuar në vitin 2023, dhe do të mbulojë një periudhë trevjeçare (2026–2028). Për të mbështetur hartimin e propozimit të planit të ri, u krye një proces i gjerë konsultimi, ku u përfshinë institucionet dhe agjencitë kryesore publike të angazhuara në zbatimin e garancisë rinore në nivel qendror dhe vendor, si dhe partnerët përkatës të shoqërisë civile. Siç parashikohet në modelin e qeverisjes së PZGR-së, grupi teknik i punës luajti një rol vendimtar në procesin e konsultimit për hartimin e planit të ri dhe grupi ndërinstitucional luajti një rol vendimtar në shqyrtimin dhe miratimin përfundimtar të tij.

Në këtë seksion të planit identifikohen masat kryesore që përcaktojnë kuadrin e planin e ri. Masat mund t'u referohen **reformave** dhe **nismave**.

- Reformat u referohen ndryshimeve ligjore, rregullatore dhe procedurale që synojnë përmirësimin e performancës së politikave publike në terma afatmesëm dhe afatgjatë. Ato u referohen kuadrove rregullatorë, ndërhyrjeve ose njohurive të strukturuara që nuk janë zbatuar ende, të cilat mund të kontribuojnë në përmirësimin e performancës së skemës së garancisë rinore në cilëndo nga fazat e saj.

- Nismat u referohen ndërhyrjeve të zbatuara nga organet publike ose në partneritet me shoqërinë civile, të cilat synojnë grupin e synuar të skemës së garancisë rinore dhe të cilat janë tashmë duke u zbatuar ose planifikohen të zbatohen së shpejti.

5.1. Hartëzimi

Kjo fazë e zbatimit të Planit të Garancisë Rinore fokusohet te përmirësimi i mbledhjes dhe analizës së të dhënave për qëllime plotësuese. Për rrjedhojë, ajo përfshin **masa që synojnë të sigurojnë një profilizim të përshtatshëm të popullsisë NEET, masa që kërkojnë të parandalojnë braktisjen dhe masa që synojnë të gjenerojnë njohuri më të mira mbi tendencat ekonomike dhe të tregut të punës.**

Në rastin e parë, qëllimi është të kuptohen më mirë karakteristikat e popullsisë dhe rrjedhimisht, të krijohen kushte më të mira për të përshtatur strategjinë e veprimit, shërbimet dhe ofertat e planit të zbatimit. Në rastin e dytë, miratohen strategji për të parandaluar rritjen e popullsisë së të rinjve NEET, të cilët largohen nga shkolla para kohe. Në rastin e tretë synohet të parashikohet zhvillimi i aftësive dhe ofertave të punës, duke mundësuar rregullim më të mirë të zhvillimit të standardeve të kualifikimeve, këshillimit për punësimin dhe instrumenteve për nxitjen e punësimit.

Gjatë fazës së parë të zbatimit të PZGR-së, u vërejtën zhvillime të rëndësishme në të gjitha fushat.

Lidhur me profilizimin, në vitin 2024 u bë i mundur rishikimi i ushtrimit të kryer në vitin 2021, duke ndërmarrë, gjithashtu, hapa për të rritur kapacitetin për mbledhjen sistematike të të dhënave për të detajuar profilizimin e popullsisë NEET. Në këtë kuptim, u krye një hartëzim i detajuar i treguesve të nevojshëm dhe u analizuan mangësitë në instrumentet e mbledhjes së të dhënave, veçanërisht në formularin e anketës së përdorur në Anketën e Forcave të Punës. Tashmë, është e rëndësishme të investohet në përmirësimin e procedurave për mbledhjen e të dhënave, në kuadër të Anketës së Forcave të Punës. **Hapat e mëtejshëm duhet të synojnë ta bëjnë profilizimin e popullsisë NEET një veprimtari periodike dhe të zgjerojnë analizën e zhvilluar në kuadër të tij.** Gjithashtu, është e nevojshme të mblidhen informacione për personat që kanë braktisur shkollën dhe të miratohen mekanizma referimi për t'i ndihmuar ata që të aksesojnë shërbimet mbështetëse në kuadër të skemës së garancisë rinore.

Sa i përket parandalimit të braktisjes së hershme të shkollës, është zgjeruar zbatimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, megjithëse vazhdon të ekzistojë nevoja për konsolidimin e strategjisë dhe të instrumenteve që mbështesin këtë qasje, duke përfshirë të strategjive mbështetëse që shkollat duhet të garantojnë për nxënësit që kanë më shumë rrezik të braktisin shkollën.

Së fundi, është thelbësore të konsolidohen zhvillimet metodologjike që lidhen me vlerësimin e nevojave për kualifikime dhe trajnim, me qëllim institucionalizimin e qasjes dhe sigurimin e informacionit përkatës për planifikimin e ofrimit të trajnimit dhe proceset e orientimit profesional.

Emërtimi i reformës/nismës	**Objektivat kyçë**	**Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)**	**Niveli**	**Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues**	**Afati i zbatimit**	**Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit (a)**
Reformat e planifikuara						
Krijimi i një kuadri rregullator për të institucionalizuar Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) në arsimin parauniversitar dhe zhvillimi i një mekanizmi referimi brenda sistemit të menaxhimit të informacionit parauniversitar (SMIP) për të referuar nxënësit që kanë braktisur shkollën në sistemin e informacionit të shërbimeve publike të punësimit.	Ulja e niveli të braktisjes së shkollës dhe e popullsisë NEET. Ngritja dhe forcimi i mekanizmit të monitorimit të performancës shkollore, përmes ndjekjes sistematike të rezultateve mësimore dhe indikatorëve të tjerë relevantë, me qëllim identifikimin e hershëm të nxënësve në rrezik dhe përmirësimin e arritjeve të tyre arsimore. Forcimi i mbështetjes arsimore për nxënësit në rrezik, përmes hartimit dhe zbatimit të programeve të synuara mbështetëse, të bazuara në nevojat e nxënësve të identifikuar, me qëllim parandalimin e dobësive në të nxënë dhe nxitjen e vazhdimësisë në arsim. Ngritja dhe integrimi i mekanizmit të referimit ndërinstitucional në sistemin e menaxhimit të informacionit parauniversitar, dhe të punësimit për të siguruar referimin sistematik të	Nxënësit në arsimin parauniversitar që kanë rrezik të braktisin shkollën ose që e kanë braktisur tashmë shkollën	Kombëtar	Ministria e Arsimit Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Do të zhvillohet në vitin 2026 dhe do të fillojë të zbatohet në vitin 2027	Nuk ka kosto direkte të lidhura

	nxënësve që kanë braktisur shkollën drejt sistemit të shërbimeve të punësimit. Lehtësimi i aksesit të nxënësve të larguar nga arsimi parauniversitar drejt shërbimeve mbështetëse të punësimit, duke synuar riintegrimin e tyre në tregun e punës përmes orientimit, këshillimit dhe masave aktive të punësimit.					
Prodhimi dhe publikimi periodik i treguesve shtesë për popullsinë NEET, në përputhje me Rregulloren e Eurostat për Anketën e Forcave të Punës (nga viti 2027 e në vijim).	Prodhimi periodik i analizës statistikore të situatës së të rinjve NEET, duke integruar tregues shtesë, në lidhje me: arsimin, punësimin dhe papunësinë, faktorët që ndikojnë në statusin NEET; Këta tregues synojnë harmonizimin e statistikave kombëtare me treguesit evropianë të NEET dhe hartimin e politikave të synuara për aktivizimin e të rinjve.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar	INSTAT	Do të zhvillohet në vitin 2026 dhe do të zbatohet në anketën e parë duke filluar nga ky vit.	Nuk ka kosto direkte të lidhura
Institucionalizimi i Observatorit të Informacionit të Tregut të Punës (OITP) si një sistem kombëtar i integruar për analizimin e tendencave të tregut të punës dhe aftësive, duke siguruar shkëmbimin e detyrueshëm dhe të standardizuar të të dhënave elektronike midis institucioneve përkatëse.	Ndryshimi i ligjit “Për nxitjen e punësimit” për të krijuar një strukturë për të prodhuar rregullisht të dhëna dhe për të analizuar tendencat e tregut të punës dhe kërkesën për aftësi, duke mandatuar shkëmbimin e standardizuar të të dhënave elektronike nga institucionet publike dhe jopublike, duke integruar të dhënat në Observatorin e Tregut të Punës dhe Aftësive dhe duke rregulluar llojet e të dhënave, detyrimet e raportimit, ndërveprimin me bazat e tjera shtetërore të të dhënave dhe nivelet e aksesit nëpërmjet	Të rinjtë në arsim të detyrueshëm dhe të mesëm. Oferta në fushën e AFP-së dhe FP-së. Në nivelin e dytë, sistemi do të mbështetë të gjithë popullsinë aktive duke ofruar informacion dhe orientim për tendencat e tregut të punës.	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	Ndryshimet në ligj do të miratohen në vitin 2027 Aktet nënligjore përkatëse do të miratohet brenda vitit 2027	Nuk ka kosto direkte të lidhura

	legjislacionit dytësor.					
Nismat e planifikuara						
Kryerja e një studimi të detajuar çdo dy vjet për të profilizuar popullsinë NEET, duke përdorur tregues të propozuar nga organizatat ndërkombëtare që monitorojnë dhe mbështesin zbatimin e garancisë rinore (Komisioni Evropian, ILO, ETF) dhe vënia e këtij studimi në dispozicion të grupeve përkatëse të interesit (vlerësimet e ardhshme parashikohen në vitin 2026 dhe më pas në vitin 2028).	Prodhimi periodik i studimeve/raporteve mbi karakteristikat e popullsisë NEET për të siguruar përshtatjen e strategjisë së veprimit dhe masave mbështetëse të PZGR-së. Forcimi i përdorimit të të dhënave, përmes vënies në dispozicion të rezultateve të studimit për institucionet publike, partnerët socialë dhe grupet e tjera përkatëse të interesit.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç, që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar	INSTAT	Do të kryhet në vitin 2026 dhe 2028	18 000 euro Buxheti i shtetit (01320)
Shtrirja e mëtejshme e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për të monitoruar rrezikun e braktisjes së shkollës pas arsimit të detyrueshëm.	Monitorimi i rezultateve shkollore dhe variablave të tjerë për të përcaktuar performancën në shkollë. Krijimi dhe zbatimi i programeve ekstrakurrikulare për të ndihmuar nxënësit që kanë rrezik të braktisin shkollën, të bazuara në nevojat e nxënësve të identifikuar, me qëllim parandalimin e dobësive në të nxënë dhe nxitjen e vazhdimësisë në arsim.	Të rinjtë në shkollat e AFP-së Të rinjtë në shkolla të përgjithshme të arsimit të detyrueshme dhe të mesëm	Kombëtar	Ministria e Arsimit Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Kombëtar në vitin 2028 Zhvillimi i programeve mësimore gjatë vitit 2027. Programet mësimore duhet të testohen në kuadër të projekteve pilot në shkollat e AFP-së që kanë më shumë përvojë në zbatimin e SPH-së. Zbatimi i projekteve pilot në vitin 2027 (për ata në vitin shkollor 2027–2028).	Kostot do të vlerësohen
Përgatitja e raporteve vjetore që analizojnë tendencat e	Informimi i rregullt i grupeve përkatëse të interesit për kualifikimet dhe	Të rinjtë në arsim të detyrueshëm dhe të mesëm.	Kombëtar	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Duke filluar nga viti 2027	127 500 euro Buxheti i shtetit

tregut të punës dhe kërkesën përkatëse për aftësi dhe kualifikime.	tendencat e punësimit bazuar në të dhënat nga Observatori i Tregut të Punës.	Oferta në fushën e AFP-s dhe FP-së. Në nivelin e dytë, sistemi do të mbështetesë të gjithë popullsinë aktive duke ofruar informacion dhe orientim për tendencat e tregut të punës.				(10550)
Mbështetje financiare për romët dhe grupet e tjera të cenueshme të të rinjve. Programi i bursave për nxënësit e shkollave të mesme (arsimi i mesëm, duke përfshirë AFP-në) nga familjet ekonomikisht të disavantazhuara, VKM për pagesat për pjesëmarrjen në trajnime profesionale.	Promovimi i aksesit të barabartë në zhvillimin e aftësive dhe përmirësimi i tranzicionit nga arsimi/AFP-ja drejt tregut të punës. Reduktimi i barrierave financiare, duke ofruar bursa të synuara dhe paketa mbështetëse për nxënësit nga familjet me të ardhura të ulëta. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes dhe frekuentimit të romëve, emigrantëve dhe të rinjve të tjerë të cenueshëm në arsimin e mesëm, duke përfshirë drejtimet e AFP-së.	Të rinjtë romë, të rinjtë emigrantë dhe nxënës të tjerë të cenueshëm nga familjet në vështirësi ekonomike. Fokus te të rinjtë e regjistruar në programet e nivelit të mesëm të lartë të AFP-së.	Kombëtar	Ministria e Arsimit Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2027–2028	Kostot do të vlerësohen

5.2 Kontaktimi

Qasja e fazës së kontaktimit është përmirësuar ndjeshëm gjatë zbatimit të PZGR-së së parë, përmes **një modeli kontaktimi të zhvilluar dhe miratuar sipas planit**. Në veçanti, u projektua një model ndërhyrjeje dhe mjete për të krijuar **partneritete vendore të fokusuara tek aktivitetet e informimit dhe për të ofruar, në koordinim me partnerët, shërbime përgatitore**. Aktualisht, modeli po testohet në rajonet e mbuluara nga faza e pilotimit të zbatimit të garancisë rinore, konkretisht në Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Hapi tjetër i natyrshëm do të jetë sigurimi, në mënyrë të koordinuar, i rregullimit dhe zgjerimit të projektit pilot dhe garantimi i krijimit të partneriteteve vendore për të mbështetur zbatimin e garancisë rinore në mbarë vendin.

Modeli i kontaktimit përfshin tri fusha të ndërhyrjes:

1. Parandalimi i hershëm – për të ulur nivelin e braktisjes së shkollës dhe për të përmirësuar suksesin arsimor.

2. Identifikimi dhe aktivizimi – përmes sistemeve të gjurmimit, shkëmbimit të të dhënave dhe partneriteteve me organizatat rinore.

3. Këshillimi dhe orientimi – ofrimi i shërbimeve të personalizuara, trajnimeve motivuese dhe referimeve te shërbimet e specializuara.

Modeli i qeverisjes i përcaktuar për kontaktimin identifikon partnerët e përfshirë në nivel rajonal dhe vendor, si dhe përcakton në detaje rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Ky zhvillim ka konsoliduar modelin e përgjithshëm të qeverisjes së PZGR-së dhe ka siguruar një strategji ndërhyrjeje me shumë nivele, të aftë për të krijuar një bashkëpunim më të lartë në praktikë dhe për të thelluar kuadrin e partneritetit të lidhur me zbatimin e garancisë rinore.

Lançimi i strategjisë së kontaktimit u mbështet nga miratimi i një mekanizmi grantesh, që financon aktivitetet e rrjeteve vendore. Përmirësimi i mekanizmit të testuar të financimit dhe forcimi i kapaciteteve të tij për të mbështetur aktivitetet e kontaktimit do të jetë, gjithashtu, një prioritet.

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli	Emri dhe roli i organizatës lider dhe partnerët bashkëpunues	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit (a)
Reformat e planifikuara						
Amendimi i ligjit 15/2019 "Për nxitjen e punësimit" me qëllim ngritjen dhe institucionalizimin e rrjeteve të partneritetit vendor dhe zhvillimi i kuadrit rregullator pasues që mbështet zbatimin e tyre.	Sigurimi i informimit dhe aktivizimit e të rinjve (NEET), përmes mekanizmave të partneritetit vendor midis aktorëve në fushën e arsimit, punësimit, formimit, mbrojtjes sociale dhe partnerëve socialë. Ngritja dhe institucionalizimi i sistemeve të referimit ndërmjet aktorëve të RrPV të të rinjve NEET të identifikuar.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç, që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ministria e Arsimit Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor	Ndryshimet në ligj do të miratohen në vitin 2027	Nuk ka kosto direkte të lidhura
Ndryshimi i mekanizmit të granteve të Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR) për të financuar strategjinë e kontaktimit	Mekanizmi i granteve i AKR-së i rishikuar për të mbështetur strategjinë e kontaktimit, duke financuar organizatat e shoqërisë civile, grupet joformale të të rinjve dhe këshillat rinorë vendorë të përfshirë në aktivitetet e informimit. Përmes kësaj skeme, AKR-ja do të identifikojë dhe regjistrojë organizatat rinore në rrjetin e partneritetit vendor, do të koordinojë dhe mbikëqyrë kontraktimin e tyre, si dhe do të nxisë pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile (OShC) në programet e garancisë rinore.	OJF-të rinore OJF-të për të rinjtë Grupet joformale rinore Këshillat Rinorë Vendorë	Kombëtar	Agjencia Kombëtare e Rinisë	Do të ndryshohet në vitin 2026 dhe do të zbatohet në thirrjen e parë në këtë vit	7 500 euro Buxheti i shtetit (08610)

Hartimi i një kuadri rregullator për punën me të rinjtë dhe për shërbimet e ofruara nga punonjësit rinorë, siç përcaktohet në ligjin e ndryshuar 75/2019, "Për rininë".	Përmirësimi dhe institucionalizimi i punës me të rinjtë, në përputhje me kuadrin rregullator, udhëhequr nga AKR-ja.	Punonjësit rinorë, siç përcaktohet në ligjin e ndryshuar 75/2019, "Për rininë".	Kombëtar	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Agjencia Kombëtare e Rinisë	2026	25 000 euro Buxheti i shtetit (08610)
Ngritja dhe operacionalizimi i zyrës lëvizëse/në distancë për mbështetjen e punësimit të të rinjve	Sigurimi i aksesit të personalizuar dhe fleksibël i shërbimeve të informimit dhe këshillimit, përmes ngritjes dhe funksionimit të zyrave në distancë/ lëvizëse për të rinjtë (që mobilizon AKPA-në, punonjësit rinorë, bashkitë/administratorët socialë). Ky model ul pengesat gjeografike dhe sociale, përmirëson koordinimin e shërbimit dhe mundëson pilotimin e metodave novatore për mbështetje të vazhdueshme për të rinjtë. Hartimi i një kuadri rregullator dhe i një Plani veprimi për operacionalizimin e njësive në distancë/lëvizëse (duke përfshirë këshilluesit e punësimit, punonjësit rinorë, administratorët socialë).	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Rinisë Bashkitë	2026–2027	25 000 euro Buxheti i shtetit (10550)
Nismat e planifikuara						
Pasurimi i "Portalit të garancisë rinore" për të shërbyer si njësi shërbimi me një ndalesë/"one-stop-shop" për të rinjtë, me qëllim marrjen e informacionit mbi mundësitë e disponueshme për punësim, arsimim ose formim, si dhe për të kontribuar në nxitjen e regjistrimit në Garancinë Rinore dhe në këshillim e formim profesional.	Përmirësimi, pasurimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i Portalit ekzistues të Garancisë Rinore, në një "zyrë shërbimi me një ndalesë" që u siguron të rinjve informacion mbi mundësitë e punësimit, arsimimit dhe formimit, si dhe mbi nisma dhe shërbime të tjera për të rinjtë, dhe që mundëson regjistrimin paraprak në Garancinë Rinore.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Rinisë	Fillon në vitin 2026	Burimi i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"
Aktivizimi i mekanizmit të granteve për OJF-të, Këshillat Rinorë Vendorë, grupet joformale rinore, që janë pjesë e Rrjetit të Partneriteti Vendor.	Konsolidimi i qasjes së bashkëpunimit në Garancinë Rinore. Qëllimi i kësaj mase është financimi i aktiviteteve të informimit që do të	60 organizata rinore, këshilla rinorë dhe grupe joformale të të rinjve që zbatojnë fazën e informimit përmes nëngranteve tek ≥ 30,000 të rinj	Fokusi do të jetë zgjerim gradual i mbulimit të territorit me qëllim që partneritetet	Agjencia Kombëtare e Rinisë Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2027	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të

	kryhen nga OJF-të, këshillat rinorë vendorë dhe grupet joformale rinore që punojnë në fushën e të rinjve.	NEET	vendore të mbulojnë të gjithë territorin brenda vitit 2028.			rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"
Zgjerimi i zbatimit të partneriteteve të rrjetit vendor (RrPV).	Zbatimi në mënyrë efektive i aktiviteteve të parashikuara në kuadër të RrPV, për kontaktimin, aktivizimin dhe referimin e të rinjve; Diversifikimi dhe forcimi i paketës së shërbimeve përgatitore për të rinjtë NEET, duke siguruar disponueshmërinë dhe përshtatjen e tyre sipas nevojave; Forcimi i aftësive të aktorëve vendor të përfshira në partneritetet për qëllimet e kontaktimit. Trajnim dhe ngritje kapacitetesh për këshilluesit e punësimit, punonjësit socialë, psikologët, stafin e qendrave komunitare dhe ditore, si dhe punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve që punojnë me të rinjtë. Forcimi i rolit të punonjësve rinorë lidhur me kryerjen e aktiviteteve të informimit, veçanërisht për grupet e cenueshme	≥ 18,000 të rinjtë NEET të identifikuar konkretisht ata që janë më të cenueshëm dhe që jetojnë në zona rurale. Subjektet e partneritetit vendor sipas modelit të propozuar të informimit. Grupi i synuar përfshin profesionistët e vijës së parë që janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve (parapërgatitore) të informimit dhe mbështetjes për të rinjtë.	Fokusi do të jetë zgjerim gradual i mbulimit të territorit me qëllim që partneritetet vendore të mbulojnë të gjithë territorin brenda vitit 2028.	AKPA-ja dhe të gjithë partnerët e tjerë të parashikuar në modelin e qeverisjes së qasjes së partneritetit vendor.	2026–2028	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"
Ngritja e një kuadri të unifikuar për monitorimin e aktiviteteve të kontaktimit dhe digjitalizimi përmes një moduli *online* për referimin e të rinjve të synuar.	Përgatitja e një kuadri të unifikuar për planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve të kontaktimit, përfshirë këtu, aktiviteteve promovuese, aktiviteteve të OJF-ve, Rrjeteve të Partneritetit Vendor, etj. Dizenjimi dhe ngritja e një moduli referimi në sistemin e informacionit të shërbimit publik të punësimit (ShPP) për t'u mundësuar referimin e të rinjve NEET për regjistrimin paraprak në Garancinë Rinore. Ky modul duhet të	Organizata rinore, aktorët e partneritetit vendor sipas modelit të propozuar të informimit.	Kombëtar	Agjencia Kombëtare e Rinisë Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	Fillon në vitin 2026	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"

	gjenerojë të dhëna të verifikueshme për referimin dhe regjistrimin paraprak të të rinjve.					
Fushata komunikimi/ndërgjegjësimi në mediat vendore dhe kombëtare, rrjetet sociale, shkollat, universitetet etj.	Forcimi i lidhjes ndërmjet institucioneve dhe të rinjve përmes komunikimit të drejtpërdrejtë, pjesëmarrjes dhe aktivizimit. Nxitja e regjistrimit në PZGR. Rritja e ndërgjegjësimit mbi programet e punësimit dhe programin e vetëpunësimit për të rinjtë NEET, duke përdorur një qasje me shumë kanale, ku përfshihen televizioni, radio, media sociale, portalet e lajmeve dhe botimet në shtypin e shkruar.	Fushata është fokusuar tek të ≥12,000 të rinj NEET, veçanërisht të rinjtë në zona rurale dhe ata që bëjnë pjesë në grupet më të cenueshme.	Kombëtar	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Rinisë	Fushatat e komunikimit do të zhvillohen gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të planit. 2026–2028	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"
Konsolidimi i vazhdueshëm i rrjetit të Këshillave Rinorë Vendorë dhe fuqizimi i tyre me burimet e nevojshme për të ushtruar funksionet e tyre në mënyrë efektive.	Forcimi dhe rritja e vazhdueshme e kapaciteteve të Këshillave Rinorë Vendorë (KRV), me fokus tek aktivizimi i të rinjve NEET. KRV-të janë struktura të ngritura me ligj. Megjithatë, duke qenë struktura relativisht të reja, ato kërkojnë forma të ndryshme mbështetjeje, në veçanti në drejtim të financimit dhe ngritjes së kapaciteteve. Forcimi i KRV-ve do të ketë ndikim të konsiderueshëm tek identifikimi, informimi dhe angazhimi i të rinjve NEET, duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë, njohje më të mirë të situatës së tyre dhe krijim të besimit, në veçanti me të rinjtë në zona rurale, ata me aftësi të kufizuara dhe të rinjtë nga komunitetet rome dhe egjiptiane ndër të tjera.	Nga aktivitetet e mbështetura nga AKR-ja do të përfitojnë 61 KRV dhe 500 punonjës rinorë.	Kombëtar	Agjencia Kombëtare e Rinisë Bashkitë	Konsolidimi i rrjetit të Këshillave Rinorë Vendorë do të zhvillohet gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të planit. 2026–2028	"BE për të rinjtë, në favor të Republikës së Shqipërisë, për vitin 2022", rezultati 1
Konsolidimi i vazhdueshëm i rolit të punonjësve rinorë në bashki dhe OJF, si dhe forcimi i kapaciteteve të tyre	Forcimi i rolit të punonjësve rinorë në bashki dhe organizata	Punonjësit rinorë në bashki dhe OJF	Kombëtar	Agjencia Kombëtare e Rinisë	Konsolidimi i rrjetit të Këshillave Vendorë të	Nuk ka kosto direkte të lidhura

për të ushtruar përgjegjësitë në mënyrë efektive.	jofitimprurëse (OJF), me fokus tek aktivizimi i të rinjve NEET. Ligji nr. 75/2019, "Për rininë", i ndryshuar, parashikon në nenin 14 figurën e punonjësit rinor dhe në nenin 14/1 konceptin e punës me të rinjtë. Siç parashikohet në ligjin nr. 75/2019, "Për rininë", roli i punonjësit rinor përqendrohet te procesi i arsimit joformal, zhvillimi i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të të rinjve, si dhe te zbatimi dhe koordinimi i punës me të rinjtë. Kjo fushë ndërhyrjeje është mjaft e rëndësishme në procesin e informimit për të rinjtë NEET.			Bashkitë	Aftësive do të zhvillohet gjatë gjithë periudhës së zbatimit të planit. 2026–2028	
Zhvillimi i standardit të kualifikimit dhe kurrikulave për të mbështetur zbatimin e një programi trajnimi në të ardhmen.	Zhvillimi i profilit profesional dhe kurrikulave përkatëse të trajnimit, me qëllim zbatimin në të ardhmen të programeve të trajnimit profesional për kualifikimin dhe certifikimin e punonjësve rinorë, në përputhje me ligjin e ndryshuar "Për rininë". Zbatimi i programeve të trajnimit nuk është planifikuar ende në kontekstin e PZGR-së.	Punonjësit rinorë, siç përcaktohet në ligjin e ndryshuar 75/2019, "Për rininë"	Kombëtar	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Agjencia Kombëtare e Rinisë	Do të zhvillohet në vitin 2027	15 000 euro, Buxheti i shtetit (08610)
Aktivizimi i grupeve joformale të të rinjve, siç parashikohet në ligjin nr. 75/2019, "Për rininë".	Grupet joformale rinore janë grupe të organizuara të të rinjve, që kanë objektiva dhe vlera të përbashkëta, kryejnë aktivitete jofitimprurëse dhe nuk janë të regjistruara si subjekte juridike, në përputhje me legjislacionin aktual. Objektivi i kësaj mase është të sigurohet që këto grupe të mbështetin identifikimin e të rinjve NEET përmes	Grupet joformale rinore, siç parashikohen në legjislacion.	Kombëtar	Agjencia Kombëtare e Rinisë	Do të zbatohet në vitin 2027	Kostoja do të vlerësohet

	aktiviteteve sociale, kulturore dhe arsimore që ata zhvillojnë.					

5.3 Përgatitja

Diversifikimi i shërbimeve përgatitore është një kusht thelbësor për efektivitetin e PZGR-së. Profilet e shumta të të rinjve NEET dhe sfidat me të cilat ata përballen gjatë kalimit në tregun e punës kërkojnë strategjive përgjigjeje më të individualizuara. Në kuadër të PZGR-së, procesi i përshtatjes së përgjigjes sipas profileve individuale është më i nevojshëm në fazën përgatitore. Shërbimet përgatitore janë ato që, në kontekstin e garancisë rinore, kërkojnë të trajtojnë mangësitë individuale specifike dhe të krijojnë kushtet që të rinjtë e regjistruar të marrin një ofertë.

Gjatë ciklit të plotë të zbatimit të PZGR-së, i është dhënë prioritet zhvillimit të një portofoli shërbimesh përgatitore, që mundësojnë një qasje të menaxhimit të rasteve. Në këtë drejtim, procesi i kontraktimit brenda Rrjeteve të Partneritetit Vendor përfshin, si objektiv, diversifikimin e portofolit të shërbimeve përgatitore, që duhet të vihen në dispozicion të të rinjve NEET, që kërkojnë një ofertë në kuadër të garancisë rinore. Zbatimi dhe testimi i këtij portofoli të gjerë shërbimesh do të kontribuojë në forcimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të shërbimit të garancisë rinore në ciklin e ardhshëm të zbatimit të planit.

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
Reformat e planifikuara					
Amendimi i ligjit 15/2019, "Për nxitjen e punësimit" me përmirësimin dhe harmonizimin e shërbimeve të punësimit sipas skemës së garancisë rinore.	Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me konceptet e garancisë rinore (përkufizimet, standardet e shërbimit, rrjeti i partneritetit vendor). Përfshirja e shërbimeve të garancisë rinore si pjesë e shërbimeve të punësimit (VKM për shërbimet; qartësimi i zbatimit përmes udhëzimeve të unifikuara). Krijimi dhe konsolidimi i emërtimit "Subjekte Integruese" për rritjen e bashkëpunimit me punëdhënësit.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional	Kombëtar Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Partnerët socialë	2027	Nuk ka kosto direkte të lidhura
Zhvillimi i mëtejshëm organizativ dhe rritja e kapaciteteve të AKPA-së. Këtu përfshihet krijimi i një grupi me punonjës të dedikuar në nivel rajoni për zbatimin e garancisë rinore.	Forcimi i kapaciteteve të AKPA-s përmes zhvillimit të stafit dhe shtimit të punonjësve të ofrimit të shërbimeve të punësimit. Harmonizimi i punës së zyrave vendore të punës duke përdorur si referencë bazën rregullatore për ofrimin e shërbimeve të punësimit sipas skemës së garancisë rinore.	AKPA Punonjës të dedikuar për Garancinë Rinore në nivel rajonal	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2026–2028	Kostot lidhur me koordinatorët e posaçëm të garancisë rinore do të vlerësohen

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
	Garantimi i ekzistencës së punonjësve të posaçëm të garancisë rinore në nivel rajonal.				
Krijimi i një kuadri kombëtar për ofrimin e shërbimeve të orientimit në karrierë, si dhe të këshillimit për punësim	Ngritja e rrjetit të koordinatorëve për orientimin në karrierë dhe këshillimit për punësim (MA, MEI/AKPA, AKR, bashkitë, AKAFPK). Profilizimi i kompetencave të përbashkëta të këshilluesve dhe trajnim bazë për këshilluesit në shkolla, punonjësit rinorë dhe këshilluesit për karrierën në bashki, si dhe këshilluesit e AKPA-s. Ngritja e modeleve të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit, në kuadër të orientimit në karrierë, si dhe të këshillimit për punësim. Standardizimi i rrugëtimit të klientit dhe formularëve lidhur me shërbimet për arsimin, ShPP-në, të rinjtë dhe shërbimet sociale.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional	Ministria e Arsimit Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Bashkitë	2026–2028	127 500 euro, Buxheti i shtetit (09120 dhe 09230)
Zhvillimi i programeve të reja të nxitjes së punësimit (PNP) për personat NEET pa arsim bazë.	Zhvillimi i programeve aktive të tregut të punës (PATP) për të ofruar kurse të shkurtra trajnimi (aftësitë bazë të shkrimit dhe leximit, aftësitë numerike dhe aftësitë digjitale) përmes krijimit të partneriteteve me ofrues privatë ose OJF. Zhvillimi i aftësive digjitale synon të forcojë aftësitë jetësore të përditshme duke u mësuar kursantëve mjete digjitale praktike, si përdorimi i *email*-it, aksesimi i shërbimeve publike ose plotësimi i formularëve *online.* Forcimi i kapaciteteve institucionale të AKPA-së dhe të këshilluesve të punëdhënësve për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe koordinimin me subjektet integruese.	Të rinjtë NEET që nuk kanë ndjekur ose përfunduar arsimin bazë	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2026–2028	Nuk ka kosto direkte të lidhura
Zhvillimi i PNP-ve të reja për të siguruar masa për rritjen e	Draftimi dhe miratimi i programit, i cili synon mbështetjen e të rinjve	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që	Qasje vendore me synim mbulimin	Në proces, 2026–2028	Nuk ka kosto direkte të lidhura

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
punësueshmërisë së të rinjve NEET. Programi i "Aftësive për punësim"	NEET për të përmirësuar gatishmërinë për punë, aftësitë për aplikim për punë dhe integrimin në tregun e punës (shërbimi përgatitor). Hartimi i udhëzimeve dhe akteve rregullatore përkatëse për zbatimin e programit.	nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	gradual të të gjithë territorit kombëtar Partnerët në partneritete vendore		
Hartimi i një kuadri rregullator për funksionimin e qendrave të integruara të punësimit dhe këshillimit (zyra shërbimi me një ndalesë), duke përfshirë ngritjen e tyre në kontekstin e modelit të qeverisjes së PZGR-së. Pilotimi i funksionimit të një zyre shërbimi me një ndalesë.	Përmirësimi i infrastrukturës së zyrave të punësimit për të siguruar zyra punësimi funksionale, gjithëpërfshirëse dhe miqësore me të rinjtë. Qendrat e integruara të punësimit dhe këshillimit do të menaxhohen në partneritet me AKPA-në, AKR-në, bashkitë dhe OJF-të, dhe do të përdoren për realizimin e aktiviteteve të kontaktimit, si dhe për të ofruar shërbime udhëzuese, këshillimi dhe orientimi për karrierën. Marrja e masave për të garantuar që të gjitha palët e përfshira në ofrimin e ofertave dhe shërbimeve përgatitore të jenë në të njëjtën linjë. Pilotimi dhe shtrirja e një modeli të integruar të shërbimeve të punësimit dhe këshillimit ("zyrat e shërbimit me një ndalesë") të menaxhuara në partneritet me AKPA-n, AKR-në, bashkitë dhe OJF-të. Ofrimi i aktiviteteve të informimit, këshillimit mbi nevojat për trajnim dhe orientimit për karrierën për të rinjtë NEET, dhe i shërbimeve gjithëpërfshirëse lehtësisht të aksesueshme (mbështetja psikosociale, mbështetja për shëndetin mendor etj.) përmes pilotimit të një zyre shërbimi me një ndalesë/zyre të integruar për të rinjtë. Këto zyra mund të jenë pjesë e rrjeteve vendore dhe të plotësojnë e	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional	Kombëtar Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Ministria e Arsimit Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Rinisë	2027–2028	Buxheti i shtetit (10550) dhe Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve"

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
	mbështetin punën që duhet të bëhet nga shërbimet në distancë/lëvizëse.				
Modernizimi i sistemit të menaxhimit të informacionit të AKPA-së	Modernizimi i sistemit të informacionit të AKPA-së për të ofruar shërbime të integruara përgatitore, profilizim, këshillim dhe monitorim, duke përfshirë përdorimin e instrumenteve inteligjentë për përputhjen e vendeve të punës, ndërfaqe shërbimesh bazuar në *chatbot;* analizat e monitorimit në kohë reale të tregut të punës etj. Garantimi i ndërveprueshmërisë me sisteme të treta për referimin, monitorimin dhe ndjekjen e rasteve (mbrojta sociale, arsimi) në kuadër të zbatimin të PZGR-së.	Të rinjtë e regjistruar në Garancinë Rinore; të rinjtë NEET të identifikuar në nivel vendor.	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit	2026–2028	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"
Nismat e planifikuara					
Forcimi i kapaciteteve të specialistëve të punësimit për zbatimin e qasjeve individuale ndaj personave të papunë. Trajnimi i specialistëve të punësimit, bazuar në kurrikulat e zhvilluara nga AKAFPK-ja.	Forcim i kapaciteteve lidhur me kryerjen e vlerësimeve gjithëpërfshirëse lidhur me rrethanat sociale, ekonomike dhe personale të të rinjve NEET, me qëllim identifikimin e mbështetjes së duhur dhe të alternativave të integrimit. Zhvillimi i seancave të profilizimit profesional për të kryer vlerësime të strukturuara, me qëllim eksplorimin e interesave, preferencave dhe aftësive individuale, duke ndihmuar në përzgjedhjen e drejtimeve të karrierës ose formimit/trajnimit (shërbimi përgatitor).	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Qasje vendore me synim mbulimin gradual të të gjithë territorit kombëtar Partnerët në partneritete vendore	2026–2028	Kostot do të vlerësohen
Ofrimi i kurseve të shkurtra të trajnimit, që trajtojnë aftësitë e punësueshmërisë së të rinjve NEET (aftësitë për kërkimin për punë, aftësitë sociale për tregun e punës dhe aftësitë digjitale).	Nxitja e aftësive për punësim dhe aftësive digjitale me qëllim lehtësimin në integrimin e të rinjve NEET në tregun e punës.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç, që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2026–2028	Nuk ka kosto direkte
Zbatimi i Programit të Riintegrimit Social,	Ofrimi i këshillimit të specializuar dhe intensiv	Të rinjtë e grupmoshës	Kombëtar Ministria e		

Emërtimi i reformës/nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
i cili synon të mbështesë përfshirjen e grupeve të disavantazhuara në tregun e punës.	për të rinjtë e cenueshëm NEET (të rinjtë NEET, që banojnë në zona të largëta, të rinjtë NEET me aftësi të kufizuara etj.). Forcimi i kapaciteteve të AKPA-së për menaxhimin dhe monitorimin e programit. Ngritja e mekanizmave të referimit për ofertat në kuadër të garancisë rinore për të diplomuarit në këtë Program.	15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive OJF-të	2026–2028	Nuk ka kosto direkte të lidhura me këtë plan
Zbatimi i njohjes së të nxënit të mëparshëm (NjNM) dhe rritja e pjesëmarrjes së të rinjve NEET në shërbimet e NjNM-së.	Forcimi i kapaciteteve të stafit për trajtimin e NEET për Njohjen e të Nxënit të Mëparshëm. Planifikimi i kualifikimeve/ programeve për NEET në kuadër të Njohjes së të Nxënit të Mëparshëm Nxitja të të rinjve NEET për certifikim të të nxënit përmes programit të NjNM-së Nxitja e kërkesës për të nxënit gjatë gjithë jetës përmes rihyrjes në programet e arsimit dhe formimit profesional.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Agjencia Kombëtare e Aftësimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	2026–2028	27 800 euro, Buxheti i shtetit (09240)
Hartëzimi i shërbimeve mbështetëse sociale për të rinjtë	Hartëzimi kombëtar gjithëpërfshirës të shërbimeve ekzistuese socioshëndetësore dhe psikosociale, të disponueshme për të rinjtë me aftësi të kufizuara të grupmoshës 15–29 vjeç. Hartëzimi do të mbulojë shërbimet publike, jopublike dhe komunitare, me fokus specifik te shërbimet e shëndetit mendor, kushtet e aksesueshmërisë, kriteret e pranueshmërisë, alternativat e referimit dhe mbulimi territorial. Grupi kryesor i synuar janë të rinjtë me aftësi të kufizuara, duke përfshirë ata në rrezik përjashtimi ose me nevoja komplekse.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Bashkitë	2026	Kostot do të llogariten

5.4 Ofertat

Faza e zbatimit të PZGR-së që tashmë ka përfunduar ka mundësuar që të arrihet progres i konsiderueshëm në drejtim të numrit dhe profilit të ofertave të përfshira në plan. **Në fazën fillestare, e cila është mbështetur në masë nga programet e nxitjes së punësimit, portofoli i ofertave u pasurua gjatë tre vjetëve të parë të zbatimit.** Falë prezantimit të programeve të reja të planifikuara për t'iu përshtatur PZGR-së është shënuar progres i dukshëm në diversifikimin e ofertave në formimin profesional, arsimin teknik dhe stazhet. **Kapaciteti për të siguruar menaxhim individual të përgjigjes në kuadër të garancisë rinore është tashmë më i fortë**, si dhe ka krijuar kushte më të mira për të nxitur rritjen e mobilizimit të të rinjve NEET dhe të efektivitetit në realizim.

Në këtë drejtim, **faza e re e zbatimit të programit duhet t'i japë përparësi konsolidimit të portofolit ekzistues të ofertave dhe jo zgjerimit të tij**. Disa nga ofertat e reja, si, për shembull, arsimi i dyfishtë apo programi "Të nxënit në vendin e punës" janë mjaft kërkuese për sa u përket burimeve, aftësive dhe përvojës së nevojshme për zbatimin e duhur dhe kjo përbën fokusin kryesor të fazës së re të skemës. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme që të **sigurohet koordinim më i mirë ndërmjet** fazave përgatitore dhe të ofertës. Në të vërtetë, krahas aspekteve të dobishme që sjell ofrimi i ofertave në numër dhe profile të mjaftueshme, është thelbësore të garantohet që ndërhyrjet në nivelin e shërbimeve përgatitore t'u mundësojnë të rinjve NEET të kenë kushtet e nevojshme për të marrë ofertat që u përshtaten më së miri profilit dhe projektit individual të tyre.

Nxitja e përfshirjes më të madhe të sektorit privat në zbatimin e ofertave është një sfidë, e cila është përcaktuar si objektiv në planin 2026–2028. Në fakt, një pjesë e konsiderueshme e ofertave të përfshira në plan kërkojnë që bizneset të ndajnë përgjegjësitë në proceset e të nxënit të të rinjve NEET dhe në ofrimin e mundësive për punësim. Në këtë drejtim, pritet që të forcohen strategjitë për të **përmirësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin e sektorit privat në PZGR**.

Ofertat e propozuara për t'u përfshirë bazohen kryesisht te masat që janë në zbatim në fushat e arsimit dhe formimit profesional, të nxënit me bazë punën (praktika profesionale dhe stazhe), si dhe të mbështetjes për punësimin dhe sipërmarrje.

Emërtimi i reformës/ nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
Reformat e planifikuara					
Rishikimi i kuadrit rregullator të AFP-së për t'u mundësuar të rinjve mbi 21 vjeç të hyjnë dhe rihyjnë në ofertën e AFP-së (ligji për AFP-në; ligji për KShK-në; ligji për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë; dhe baza ligjore që rregullon pranimet dhe strukturat e programit).	Zgjerimi i aksesit në AFP për të rriturit dhe të rinjtë mbi 21 vjeç, duke përfshirë për ata që e kanë braktisur arsimin herët, ose që kanë nevojë për riaftësim. Lehtësimi i ri/hyrjes fleksibël në programet e AFP-së, duke përfshirë opsionet modulare/me kohë të pjesshme, për të mbështetur rritjen e aftësive dhe ndryshimet e karrierës. Harmonizimi i	Të rinjtë dhe të rriturit e grupmoshës 21–29 vjeç (dhe më të mëdhenj, sipas rastit), që: - nuk janë në arsim dhe formim. kanë kualifikim të ulët. kanë nevojë për riaftësim/rritje të aftësive për të rritur punësueshmërinë.	Kombëtar. Institucioni lider: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Ministria e Arsimit Partnerët: AKAFPK-ja, AKPA, ofruesit publikë dhe jopublikë të AFP-së, partnerët socialë, rrjetet e partneritetit vendor.	2026–2027	Nuk ka kosto direkte të lidhura

Emërtimi i reformës/ nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
	kuadrit rregullator të AFP-së me nevojat e tregut të punës dhe parimet e të nxënit gjatë gjithë jetës.				
Ndryshime në programet e nxitjes së punësimit për t'i bërë ato më tërheqëse për punëdhënësit/ partnerët zbatues.	Prezantimi i konceptit të "subjektit integrues" për të formalizuar dhe për të thjeshtuar pjesëmarrjen e punëdhënësve/OJF-ve në PNP. Rritja e incentivave financiare për punëdhënësit që të punësojnë të rinj, veçanërisht punëkërkuesit të rinj NEET pjesë e grupeve vulnerabël. Integrimi dhe thjeshtimi i procedurave për zbatimin, përzgjedhjen dhe rimbursimin për të reduktuar barrën administrative. Standardizimi dhe harmonizimi i të gjitha PATP-ve me modelin e shërbimit të garancisë rinore. Forcimi i përfshirjes së anëtarëve të RrPV-së, ofruesve të AFP-së dhe në zbatimin e PAPTP-ve.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Partnerët zbatues Anëtarët e RrPV-së	2026–2027	Nuk ka kosto direkte të lidhura
Forcimi dhe përditësimi i programeve të shanseve të dyta për përmirësimin e efektivitetit të tyre.	Përditësimi i programeve të shanseve të dyta për të riangazhuar në mënyrë efektive të rinjtë që e kanë braktisur herët arsimin dhe për t'i pajisur ata me aftësitë, kualifikimet dhe orientimet përkatëse. Përmirësimi i efektivitetit të këtyre programeve për t'u mundësuar të rinjve NEET që kanë braktisur shkollën për të përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe	Të rinjtë NEET – Personat që e kanë braktisur herët shkollën	Ministria e Arsimit	2027	Nuk ka kosto direkte të lidhura

Emërtimi i reformës/ nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
	për të arritur nivelin e shkollimit që kërkohet për të vazhduar studimet ose për t'u regjistruar në programet e arsimit dhe formimit profesional.				
Nismat e planifikuara					
Diversifikimi i ofertës së AFP-së me fokus te zgjerimi i ofrimit të kurseve profesionale postsekondare të nivelit V të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.	Përditësimi në mënyrë të vazhdueshme i Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale me kualifikime postsekondare, të bazuara në nevojat për aftësitë në tregun e punës.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve	Në proces, 2026–2028	Nuk ka kosto direkte të lidhura
Zgjerimi i PNP-ve për financimin e kurseve të trajnimit të ofruara nga ofruesit jopublikë në sektorët e rinj përveç kodimit/TIK-ut, në përputhje me nevojat e tregut të punës.	Pasurimi dhe diversifikimi i ofertës së kurseve të formimit profesional të ofruara nga institucionet private të formimit profesional, duke mundësuar kualifikimin dhe rikualifikimin e të rinjve NEET që kërkojnë punësim, me qëllim përgatitjen e tyre për integrim të shpejtë në tregun e punës.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç, që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Në proces, 2026–2028	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"
Përditësimi i ofertës së kurseve të formimit profesional	Përditësimi i vazhdueshëm i ofertës për kurse afatshkurtra, duke zhvilluar programe kursesh të unifikuara bazuar në nevojat për aftësi në tregun e punës.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Kombëtar Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Në proces, 2026–2028	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"
Zbatimi i programeve mbështetëse dhe të trajnimit, në kuadër të garancisë rinore, përmes skemave të grantimit ndaj	Ofrimi i mbështetjes financiare dhe teknike për institucionet e AFP-së për të ofruar programe të	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që ndjekin programet e AFP-së, duke	**Kombëtar** Institucioni lider – Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe	2026–2028	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional

Emërtimi i reformës/ nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
institucioneve të AFP-së.	përditësuara dhe të orientuara drejt tregut të punës. Forcimi i komponentëve të trajnimit praktik, partneriteteve me biznesin, orientimit për karrierën, parandalimit të braktisjes së shkollës dhe shërbimeve të riintegrimit. Lehtësimi i tranzicionit nga shkolla në punë për të rinjtë, në përputhje me rekomandimet e garancisë rinore të BE-së.	përfshirë ata në rrezik braktisjeje ose që kanë nevojë për mbështetje për kalimin në punësim (shifrat mbeten për t'u përcaktuar).	Aftësive (AKPA) Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Partnerët – Ofruesit e AFP-së (publikë dhe jopublikë), bizneset, bashkitë, rrjetet e partneritetit vendor.		Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"
Konsolidimi dhe zgjerimi i ofertës së programeve të AFP-së në formën e dyfishtë, të cilat ofrohen në partneritet me punëdhënësit.	Kualifikimi i të rinjve për tregun e punës përmes programeve të AFP-së në formën e dyfishtë, në të cilat bizneset kanë të paktën 50% pjesëmarrje në zbatimin e kurrikulës.	Të rinjtë e grupmoshës 15–29 vjeç që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional.	Program pilot Agjencia Kombëtare e Aftësive, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Shtrirje progresive në kontekstin e programit pilot gjatë periudhës 2026–2028	Nuk ka kosto direkte të lidhura
Përmirësimi i infrastrukturës së ofruesve të AFP-së.	Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës, kabineteve dhe laboratorëve të specializuar në shkollat e AFP-së dhe qendrat publike të trajnimit për të siguruar ofrimin e arsimit profesional cilësor dhe kurseve afatshkurtra të trajnimit. Harmonizimi i mjediseve të të nxënit me standardet teknologjike që kërkohet nga tregu i punës, duke përmirësuar të nxënit praktik dhe rezultatet e punësueshmërisë	Nxënësit e regjistruar në programet formale të AFP-së dhe pjesëmarrësit në kurset afatshkurtra të trajnimit.	Nismë kombëtare e zbatuar përmes shkollave të përzgjedhura të AFP-së dhe qendrave të trajnimit. Institucioni lider: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit Partnerët: AKAFPK-ja, AKPA, ofruesit e AFP-së, bashkitë, organizatat e punëdhënësve.	2026–2028	Burimi kryesor i financimit do të jetë Programi Operacional Shumëvjeçar "BE për punësimin e të rinjve, në favor të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 2024–2027"

Emërtimi i reformës/ nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
	për të rinjtë.				
Vlerësimi gjithëpërfshirës i ndikimit të programeve të nxitjes së punësimit, në përputhje me standardet dhe kriteret e garancisë rinore dhe EMCO-së, duke përfshirë gjurmueshmërinë e përfituesve të ofertave të garancisë rinore sipas treguesve të ndjekjes nga EMCO-ja.	Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit së politikave ekzistuese aktive të tregut të punës (PATP), me fokus të veçantë te masat që synojnë të rinjtë dhe grupet e cenueshme, me periodicitet vjetor dhe 4-vjeçar. Identifikimi i programeve që gjenerojnë rezultate më të mira punësimi (hyrja në punë, qëndrueshmëria, fitimet, përftimi i aftësive) dhe i grupeve përkatëse. Sigurimi i një baze me evidenca/fakte për të riprojektuar, përshkallëzuar, ndërprerë ose kombinuar masa, në kuadër të programeve të reja të nxitjes së punësimit dhe të garancisë rinore.	Përfituesit e PATP-ve të zbatuara nga AKPA gjatë një periudhe referencë të përcaktuar (p.sh. 2024–2027), duke përfshirë: të rinjtë e papunë të grupmoshës 15–29 vjeç, të papunët afatgjatë, gratë, personat me kualifikime të ulëta dhe grupet e tjera të cenueshme.	Vlerësim në nivel kombëtar. Institucioni lider: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Partnerët: INSTAT, Ministria e Financave, ndoshta një institucion ose konsorcium i jashtëm kërkimor/vlerësimi; Rrjetet e Partneritetit Vendor për të marrë të dhëna cilësore.	2028 (projektimi në vitin 2027, përgatitja e të dhënave dhe zbatimi i vlerësimit në vitin 2028; raportimi përfundimtar në fund të vitit 2028).	Kostot do të llogariten
Ofrimi i shërbimeve të punësimit ndaj të rinjve NEET	Ofrimi i shërbimeve të integruara të punësimit për të rinjtë NEET, duke përfshirë intervistimin, këshillimin individual dhe në grup, mentorimin dhe mbështetjen e personalizuar për integrimin e qëndrueshëm në tregun e punës. Lehtësimi i përputhjes efektive ndërmjet profileve të të rinjve NEET dhe vendeve të lira të punës, përmes ndërmjetësimit aktiv të punësimit, mbështetjes së punëdhënësve gjatë gjithë procesit të rekrutimit, përgatitjes së kandidatëve për	10,000 të rinj NEET të punësuar përmes ofrimit të shërbimeve të punësimit dhe të ndërmjetësimit	**Kombëtar/ Vendor** Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	2026–2028	Nuk ka kosto direkte të lidhura

Emërtimi i reformës/ nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
	proceset e përzgjedhjes dhe intervistimit, si dhe ndjekjes sistematike pas punësimit me punëdhënësit dhe të rinjtë, me qëllim sigurimin e një integrimi të suksesshëm dhe të qëndrueshëm në punë.				
Zbatimi i programeve të nxitjes së punësimit për të rinjtë e cenueshëm NEET që rrezikojnë hyrjen në tregun e punës	Përmirësimi i punësimit dhe punësueshmërisë së individëve të rinj, duke u përqendruar te grupet e cenueshme, duke zbatuar një sërë programesh të nxitjes së punësimit, duke përfshirë programin e "formimit nëpërmjet punës", subvencionet e pagave, programin e praktikave të punës, programin e formimit dhe të punëve në komunitet, programin e trajnimit, subvencionet për programet e akomodimit të arsyeshëm dhe programe të tjera të nxitjes së punësimit që janë në fuqi gjatë periudhës së zbatimit.	9000 të rinj të cenueshëm NEET përfitues të PNP-ve, të cilët marrin mbështetje të përshtatur sipas nevojave të tyre	Kombëtar Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Në proces, 2026–2028	Programi Operacional i BE-së për punësimin e të rinjve (burimi kryesor i financimit) dhe buxheti i shtetit (10550)
Zbatimi i Programit të Vetëpunësimit	Nxitja e vetëpunësimit përmes krijimit të bizneseve të reja nga të rinjtë e papunë NEET. Programi i vetëpunësimit mbështet ngritjen e sipërmarrjeve të reja, duke ofruar trajnim mbi sipërmarrjen dhe zhvillimin e planit të biznesit për kandidatët përkatës, si dhe një	Të paktën 350 rinj NEET kanë nisur një biznes falë mbështetjes së marrë gjatë periudhës 2026–2028	Kombëtar Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive	Në proces, 2026–2028	Programi Operacional i BE-së për punësimin e të rinjve (burimi kryesor i financimit) dhe buxheti i shtetit (10550)

Emërtimi i reformës/ nismës	Objektivat kyçë	Grupi i synuar, duke përfshirë numrin e personave të mbuluar (nëse disponohet)	Niveli, organizata lider dhe partnerët	Afati i zbatimit	Kostoja e zbatimit, nëse ka, dhe burimi i financimit
	subvencion për ata persona që u miratohen kërkesat.				
Zbatimi i Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Publike (bëhet pjesë e ofertës së garancisë rinore)	Ofrimi i një përvoje pune të integruar dhe ndërvepruese me profesionistët e administratës publike. Programi do të bëhet pjesë e ofertës së garancisë rinore, duke siguruar ofrimin e shërbimit dhe monitorim pasues, në përputhje me standardet e garancisë rinore.	Të rinjtë e grupmoshës 21–29 vjeç, që nuk janë të përfshirë në arsim, punësim apo formim profesional. Kandidatët duhet të kenë diplomë të arsimit të lartë.	Kombëtar Ministria e Kulturës, Turizmit dhe Sportit Agjencia Kombëtare e Rinisë	Në proces, 2026–2028	285 000 euro, Buxheti i shtetit (08610)

Kostoja totale e planit të zbatimit të garancisë rinore 2026–2028

Faza e garancisë rinore	Total	Buxheti i shtetit	Bashkimi Evropian
Hartëzimi	EUR 145,500	EUR 145,500	-
Kontaktimi	EUR 1,505,090	EUR 324,803.5	EUR 1,180,286.5
Përgatitja	EUR 8,455,300	EUR 1,865,360.0	EUR 6,589,940
Oferta	EUR 47,667,931.8	EUR 9,867,424.2	EUR 37,800,507.5
Total	EUR 57,773,821.8	EUR 12,203,087.8	EUR 45,570,734

6. Modeli i qeverisjes dhe qasja e partneritetit

Modeli i qeverisjes së garancisë rinore në Shqipëri, i krijuar në vitin 2022, u projektua për të siguruar hapësirë të përshtatshme për pjesëmarrjen e subjekteve përkatëse në koordinimin dhe zbatimin e tij, dhe në të njëjtën kohë, ka përdorur një strukturë organizative të thjeshtë dhe transparente. Gjithashtu, modeli kërkon të integrojë dimensionet strategjike, ekzekutive dhe operacionale, për të krijuar kushte të favorshme për koordinimin, menaxhimin dhe zbatimin efektiv të planit.

Modeli ka rezultuar efektiv. Megjithatë, përvoja e fituar dhe drejtimi i ndjekur gjatë zbatimit të programit rekomandojnë që të bëhen disa përshtatje në modelin e qeverisjes, në veçanti për të forcuar kushtet për zbatimin e qasjes vendore. Prandaj, në këtë PZGR të ri është përditësuar modeli i qeverisjes së garancisë rinore. Prioritetet që do të merren në konsideratë duhet të trajtojnë:

- Forcimin e praktikës bashkëpunuese dhe shtimin e kontributit të secilit anëtar;
- Përmirësimin e dimensionit ndërsektorial të politikave rinore dhe pasqyrimin këtij dimensioni në strategjinë e qeverisjes;
- Marrjen e veprimeve në përputhje me kontekstin e territoreve dhe përfituesve të Programit;
- Përshtatjen e propozimeve sipas kontekstit strategjik të koordinimit në nivel evropian (Komisioni Evropian);
- Modeli i qeverisjes së garancisë rinore përforcon qasjen e tij me shumë nivele dhe nxit zgjerimin e kuadrit pjesëmarrës në zbatimin e tij. Qeverisja e PZGR-së përfshin tri nivele:

- Niveli qendror i koordinimit, i cili siguron orientim strategjik, menaxhim të përgjithshëm, monitorim të përgjithshëm të zbatimit dhe integrim sektorial;

- Niveli rajonal i ndërveprimit, i cili është përgjegjës për planifikimin dhe koordinimin sektorial të qasjes së bashkëpunimit, në veçanti në zonat ku ofrohen shërbimet e informimit dhe ato përgatitore;

- Niveli vendor i veprimit, i cili është përgjegjës për operacionalizimin e strategjive dhe të instrumenteve të miratuara nga partneritetet vendore që mbështetin zbatimin e PZGR-së;

- Modeli i propozuar i qeverisjes së PZGR-së është nën koordinimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si institucioni qeverisës përgjegjës për politikat e punësimit dhe formimit profesional, si dhe koordinatori i një grupi të gjerë institucionesh nga fushat e punësimit, formimit profesional, arsimit dhe rinisë. Masat zbatuese do të përfshijnë, gjithashtu, pjesëmarrjen e aktorëve në shumë nivele, siç janë bashkitë, dhe mobilizimin e një kontributi më të fortë të OJF-ve, kryesisht të atyre në fushën e mbështetjes së të rinjve (në veçanti të atyre në situatë të cenueshme). Gjithashtu, masat institucionale në PZGR parashikojnë funksionimin e një platforme koordinimi dhe monitorimi (Komiteti i Monitorimit), e cila siguron integrimin e sektorëve të ndryshëm përkatës të politikave.



Koordinimi në nivel kombëtar

Koordinimi në nivel kombëtar i garancisë rinore është nën përgjegjësinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Koordinatori Kombëtar është zëvendësministri përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Koordinatori kombëtar i garancisë rinore është përgjegjës për koordinimin e zbatimit të planit, për dhënien e udhëzimeve për AKPA-në (drejtori ekzekutiv), për monitorimin dhe raportimin pranë Zyrës së Kryeministrit dhe Komisionit Evropian, në lidhje me progresin e reformave dhe ndërhyrjeve të lidhura Garancinë Rinore, për sistemin e monitorimit dhe vlerësimit, si dhe për kryesimin e seancave të takimeve të grupit ndërinstitucional dhe grupit teknik të punës.

Koordinimi ekzekutiv

Koordinimi ekzekutiv i Planit të Garancisë Rinore është përgjegjësi e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe rrjedhimisht, koordinatori ekzekutiv është drejtori i përgjithshëm i kësaj agjencie. Koordinatori ekzekutiv është përgjegjës për menaxhimin e planit dhe për koordinimin e zbatimit të instrumenteve të parashikuara në të, si dhe për koordinimin e përgjithshëm të qasjes vendore.

Grupi ndërinstitucional

Grupi ndërinstitucional i punës është kryesisht një organ konsulence dhe përfshin të gjithë sektorët e qeverisë që luajnë një rol me rëndësi në politikat rinore, si dhe është përgjegjës për ofrimin e udhëzimeve dhe mbikëqyrjen e procesit të hartimit të PZGR-së dhe zbatimit të skemës së garancisë rinore në Shqipëri. Grupi ndërinstitucional i punës luan, gjithashtu, rol në

monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar për Garancinë Rinore dhe rishikon çdo ndryshim, që mund t'i bëhet këtij plani.

Grupi teknik i punës

Funksioni drejtues ekzekutiv i programit mbështetet nga një grup pune me natyrë teknike që mbledh bashkë përfaqësues të subjekteve përgjegjëse për zbatimin e masave të politikave të përfshira në plan. Përgjegjësitë e tij kryesore janë:

- Sigurimi i zbatimit të masave nën përgjegjësinë e tij;
- Gjenerimi i informacionit për monitorimin dhe vlerësimin e masave nën përgjegjësinë e subjekteve anëtare;
- Raportimi, pranë Koordinatorit Kombëtar dhe Komitetit të Monitorimit, i informacionit që nevojitet për sistemin e monitorimit të garancisë rinore dhe për ushtrimet e vlerësimit që mund të zhvillohen;
- Përshtatja dhe ndryshimet në portofolin e masave nën përgjegjësinë e tij, sipas udhëzimeve të përcaktuara në nivelet e koordinimit dhe monitorimit;
- Mbikëqyrja e funksionimit të Rrjetit të Partneritetit Vendor;
- Grupi Teknik i Punës (GTP) vepron në dy nivele ndërhyrjeje: në nivel të koordinimit të politikave, ku diskutohen dhe dakordësohen prioritetet dhe angazhimet politike, si dhe në nivel teknik, ku projektohen reformat dhe nismat dhe ku trajtohen aspektet e zbatimit; grupi teknik i punës luan rol kyç në zbatimin e Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore; mandati i tij përcaktohet me urdhër të Kryeministrit, i cili parashikon që Grupi Teknik i Punës:
- Të mbikëqyrë zbatimin e planit dhe të përgatisë përditësimet dhe rishikimet përkatëse për t'ia dorëzuar Grupit Ndërinstitucional të Punës për shqyrtim;
- Të jetë përgjegjës për zbatimin e masave të politikave të përfshira në plan dhe të propozojë ndryshime periodike për vijimësinë e procesit;
- T'i raportojë Koordinatorit Kombëtar dhe Grupit Ndërinstitucional të Punës të gjithë informacionin e nevojshëm për sistemin e monitorimit të garancisë rinore.

GTP-ja do të ketë përgjegjësi shtesë për mbikëqyrjen dhe monitorimin e aktivitetit të rrjeteve vendore. Progresi për zbatimin e planit kërkon, gjithashtu, rritje të pjesëmarrjes të GTP-së, konkretisht në lidhje me mbështetjen për të përditësuar qasjen e zbatimit, mjetet përkatëse dhe zhvillimin e instrumenteve të reja.

Rrjeti i Partneritetit Vendor është një mekanizëm bashkëpunues i krijuar për të përmirësuar koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve për të rinjtë dhe grupet e interesit. Qeverisja e Rrjetit të Partneritetit Vendor synon të garantojë infrastrukturën dhe përbërjen e nevojshme për zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse për identifikimin dhe aktivizimin e të rinjve NEET, si dhe të një mekanizmi të koordinuar të ndërhyrjeve territoriale për të mbështetur të rinjtë NEET.

Modeli i qeverisjes së qasjes vendore është si më poshtë:



Në nivel qendror, mekanizmi mbikëqyret nga grupi teknik i punës për zbatimin e garancisë rinore, ndërsa koordinimi i zbatimit kryhet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Në niveli rajonal, koordinimi i Rrjetit të Partneritetit Vendor do të kryhet nga drejtoritë rajonale të AKPA-s dhe anëtarët do të përfshijnë drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, shërbimet sociale shtetërore, drejtoritë e shërbimeve sociale dhe rinore në bashki dhe këshillat rinorë vendorë. Në nivel vendor, zbatimi dhe koordinimi operacional do të kryhen nga zyrat vendore të punësimit, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore/administratorët socialë, institucionet e arsimit dhe formimit profesional, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë.

Rrjetet e partneritetit vendor mund të ndërhyjnë në faza të ndryshme të planit, si për shembull në fazat e hartëzimit, informimit, përgatitjes dhe ofertës. Ndërhyrja e tyre gjatë zbatimit të Planit të Garancisë Rinore lidhet me atributet e tyre dhe aktivitetet kontraktuale, që zhvillojnë në kontekstin e planit.

Pavarësisht detyrave specifike të caktuara, modeli i partneritetit vendor duhet të sigurojë përcaktimin formal të roleve dhe përgjegjësive të çdo partneri në këtë partneritet, si dhe formulimin e synimeve të dakordësuara, në përputhje me planin e aktiviteteve të përcaktuar në nivel vendor.

7. Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi dhe vlerësimi janë elemente thelbësore për zbatimin efektiv të planit. Ambicia për ta përshkallëzuar planin në mbarë vendin dhe për të mobilizuar më shumë burime publike, nënvizon më tej rëndësinë e mekanizmave të konsoliduar të monitorimit dhe vlerësimit. Sipas rastit, plani parashikon sa më poshtë:

Do të përgatiten **raporte vjetore monitorimi** për zbatimin e planit, të cilat do të përfshijnë treguesit e drejtpërdrejtë të monitorimit dhe ndjekjes, të përcaktuar sipas kuadrit të EMCO-s. Në rolin e saj si Koordinatore Ekzekutive e planit, AKPA-ja do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e raporteve të monitorimit.

Një vit përpara përfundimit të ciklit të zbatimit do të kryhet një **vlerësim i pavarur** për të siguruar evidenca kritike për rishikimin e planit dhe për të informuar projektimin e ciklit pasues të zbatimit. Vlerësimi do të përfshijë aspektet e procesit dhe të ndikimit për të siguruar një analizë gjithëpërfshirëse të zbatimit të planit. Për sa i përket ndikimit, **vlerësimi i ndikimit të**

PZGR-së duhet të jetë në përputhje me vlerësimin gjithëpërfshirës të ndikimit të PNP-ve, në përputhje me standardet dhe kriteret e garancisë rinore dhe EMCO-s.